



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Marketing”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr Elena Kokthi

2. Dr Irma Shyle

Shkurt /2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Master i Shkencave në "Marketing" ofruar nga Universiteti i

Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Marketing Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Marketing"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 510, datë 08.11.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH nr.297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (2021-2022)	15 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2019 -2020: 60 studentë 2020 – 2021:75 studentë 2021 – 2022: 81 studentë Total 3 vite: 216 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Fakulteti Ekonomik (FE) në Universitetin e Tiranës (UT) më tej FEUT, është një institucion publik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universiteti i Tiranës, është akredituar Institucionalisht me Vendim Nr. 84, datë 27.10.2013 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 4 vite (burimi ASCAL). Afati i vlefshmërisë së akreditimit institucional përfundon në 26.10.2022. Programi i studimit në shqyrtim, Master Shkencor në Marketing ofrohet nga FE.

Fakulteti i Ekonomisë është i përbërë nga gjashtë departamente:

- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Financës
- Departamenti i Kontabilitetit
- Departamenti i Marketing Turizmit
- Departamenti i Menaxhimit
- Departamenti i Statistikë Informatikë e Zbatuar

Departamenti i Marketing-Turizëm (DMT) ofron programin e studimit Master Shkencor në “Marketing” i licencuar me UMASR VKM Nr.510, datë 08.11.2010. Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 “Programi i studimit synon të ofrojë specialistë në fushën e marketingut, sektor me shumë interes për vet specifikat e zhvillimit vendas, rajonal dhe global. Në këtë kontekst ky program studimi ka një rëndësi të veçantë për tregun e punës. Stafi i angazhuar në këtë program studimi është i përkushtuar dhe posedon eksperiencën e nevojshme për të ofruar një shërbim cilësor. Proaktiviteti dhe angazhimi për të institucionalizuar proceset që lidhen me cilësinë e programit të studimit është një pikë e fortë për konkurrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e programit të studimit. Gjithashtu, ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm i programit të studimit, i mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga BE-ja, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca. Megjithatë GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të evidentuar konkretisht kompetenca dhe aftësi që lidhen direkt me Masterin Shkencor Marketing. IAL disponon të gjitha mundësitë si nga këndvështrimi metodologjik por edhe në drejtim të rrjetit të aktorëve që akseson nëpërmjet bordeve të punës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Shkencor në Marketing ofruar nga Departamenti i Marketing-Turizëm pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm.

Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë edhe gjatë vizitës në Fakultetin Ekonomik të zhvilluar në datat **26 dhe 27 Shtator 2022** sipas një agjende të hartuar nga GVJ me asistencën e ASCAL.

Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ zhvilloi takime me: Dekanin e FE dhe Përgjegjës të Departamentit të Marketing-Turizëm, me Zyrën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, stafin e Sekretarisë Mësimore si dhe studentët që ndjekin programin e studimit. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë IAL. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin objektivisht performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Profesor i Asociuar Elena Kokthi dhe Dr Irma Shyle. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Aviola Bardhi, përfaqësuese e ASCAL. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Më datë 19/12/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/179 Prot., datë 19/12/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

UT nuk ka kthyer asnjë përgjigje mbi këtë draft.

Pasi ka kaluar çdo afat i mundshëm ligjor për kthimin e përgjigjes, drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Marketing”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Master Shkencor në Marketing i ofruar nga Departamenti i Marketing-Turizëm (DMT) në Fakultetin Ekonomik (FE), në Universitetin e Tiranës (UT), është hartuar duke marrë parasysh traditën e IAL-së, nevojat e tregut të punës si dhe ecurinë e proceve zhvillimore të vendit. Programi synon pajisjen me kompetenca dhe aftësi të nevojshme në marketing dhe proceset sipërmarrëse që lidhen me të dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kombëtare.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Marketing, neni 6, 7, 8.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Master Shkencor në Marketing është pjesë e programeve të studimit të ciklit të dytë të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Nr.510, datë 08.11.2010 për hapjen e programeve të studimit “Master i Shkencave në Universitetin e Tiranës” (1.5 Rregullore e programit të studimit, Kreu 2, neni 4).</p> <p>Programi i studimeve Master Shkencor në Marketing ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e departamentit të Marketing-Turizëm. Ky program studimi ka për qëllim tu ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve të mirëfilltë në fushën e marketingut. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e marketingut.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Marketing, neni 5 Misioni dhe Objektivat</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të studentëve në fushën e Marketingut . Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, ky program studimi është në përputhje të plotë me sa më sipër dhe ofron mundësinë që studentët të ndjekin studimet e doktoratës duke rritur mundësitë për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Marketing, neni 5 Misioni dhe Objektivat</i></p>
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur	<p>Ky program studimi pajis studentët me aftësi teorike dhe praktike, i zhvillon njohuritë dhe aftëson studentët në drejtim të:</p> <p>I. Kuptimit, analizës dhe përdorimit aplikativ të kanaleve të marketingut,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 5

zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>II. Të kërimit në terren në fushën e marketingut dhe,</p> <p>III. Të komunikimit të integruar në marketing dhe</p> <p>IV. Marketing social, institucional, ndërkombëtar, sipërmarrës etj.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në një departament i cili ka mundësi potenciale në reflektimin e nevojave të tregut sa i përket ndërthurjes së aftësive të marketingut në sipërmarrjet turistike. Megjithatë, ky aspekt nuk është aktualisht prezent në këtë program studimi. Nga takimi me stafin e angazhuar në programin e studimit, u paraqitën mendimet për të sjellë në mënyrë më eksplicite në program ndërthurjen e moduleve të marketingut me ato të turizmit. Kjo nevojë ndërthurje paraqitet edhe në planin strategjik të Departamentit Marketing-Turizëm 2020-2025. Në analizën SWOT të departamentit paraqitet si pikë e fortë aftësia për tu përshtatur me ndryshimet në tregun e punës, por GVJ vlerëson që duhet të bëhet me shumë përpjekje për të ndërthurrur marketingun me turizmin në një program të vetëm studimi. Pasi multidisiplinariteti është një nevojë e kohës jo vetëm në Shqipëri por edhe në tregun rajonal dhe global.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor, sylabuset e lëndëve</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizëm 2020-2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i Programit Master i Shkencave në Marketing</i></p>								
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Ky program studimi i ofron studentëve kompetenca në metoda, teknika dhe instrumenta të kërimit shkencor në Marketing duke mundësuar përvetësimin e kompetencave dhe aftësive shkencore për vazhdimësinë e studimeve të thelluara në ciklin e tretë të studimeve. Programi Master Shkencor “Marketing” gjithashtu garanton formimin dhe aftësimin e studentit për kërkimin shkencor pasi në përbërje të kurrikulës ka lëndë specifike për metodat e kërimit dhe një numër i konsiderueshëm kreditesh i alokohen punës së studentit, e cila fokusohet tek tema e masterit e udhëhequr nga një ekspert i fushës.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Marketing, neni 5 Misioni dhe Objektivat</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor, sylabuset e lëndëve</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1480 756 1563">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="756 1480 991 1563">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="991 1480 1225 1563">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1225 1480 1431 1563">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1563 756 1608"></td> <td data-bbox="756 1563 991 1608"></td> <td data-bbox="991 1563 1225 1608"></td> <td data-bbox="1225 1563 1431 1608">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të</p>	<p>Bazuar në Statutin e UT si dhe Planin Strategjik (2018 – 2023), programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin institucional të UT-së. Kjo reflektohet edhe nga kërkesa në rritje për të ndjekur studimet në</p>



<p>strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Masterin Shkencor Marketing. Si dhe një trend pozitiv në mesataren e studentëve që zgjedhin këtë program studimi (nga 6.9 në 7.1). Një nga objektivat e institucionit (UT) është ruajtja dhe avancimi i profilit të tij. Ky program studimi është në përputhje me këtë objektiv dhe e çon përpara atë, GVJ e vlerëson pozitivisht faktin që në strategjitë e zhvillimit të DMT por edhe në Planin strategjik të vet programit të studimit, paraqitet si nevojë pasja në konsideratë të vazhdueshme e ndryshimeve ekonomike, sociale dhe teknologjike që influencojnë direkt nevojat për kompetenca të reja në tregun e punës. Megjithatë ashtu si paraqitet nga vet IAL, stafi është i mbingarkuar me orë mësimore dhe kjo ul kohën në dispozicion të kërkimit dhe ndërkombëtarizimit. <i>Evidenca 1.1 Statuti i ri UT me shkresë</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit UT (2018-2023)</i> <i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizëm 2020-2025</i> <i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i Programit Master i Shkencave në Marketing</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet dhe zbatohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e përgjithshme të IAL-së si edhe atë të njësisë kryesore e njësisë bazë. Bazuar në planin e zhvillimit të FE-së por edhe DMT, programi i studimit synon të formojë kërkues të rinj të cilët janë të orientuar drejt aktiviteteve akademike dhe kërkimore. Programi është reflektim i prioriteteve të shkruara në statutin e UT-së dhe rregulloren e DMT por GVJ rekomandon që të integrohen në program më shumë koncepte të marketingut digjital dhe të gjithë elementëve që lidhen me digjitalizimin e shërbimeve marketing në turizëm por edhe të analizës së sjelljes konsumatore në këtë sektor. <i>Evidenca 1.1 Statuti i ri UT me shkresë</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit UT (2018-2023)</i> <i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizëm 2020-2025</i> <i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i Programit Master i Shkencave në Marketing</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Marketing” është i përshtatshëm për nivelin e studimeve të ciklit të dytë si nga forma, përmbajtja ashtu dhe shtrirja kohore. Ky program studimi ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (4 semestra) dhe emërtimi i tij është i përshtatshëm sa i përket komunikimit të tij te studentët target. Programi i studimit, është në përputhje dhe vazhdimësi me një nga fushat e drejtimit akademik të institucionit, atë të Menaxhimit Marketingut dhe Turizmit. Kjo konfirmohet edhe nga profili i studentëve që zgjedhin këtë master. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë program studimi, u konstatua që studentët që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në</p>

	<p>Marketing kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në Financë dhe Administrim Biznesi.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing, neni 5 Misioni dhe Objektivat</i></p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i ri UT me shkresë</i></p> <p><i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit UT (2018-2023)</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizëm 2020-2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i Programit Master i Shkencave në Marketing</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me prioritetet kombëtare e rajonale për zhvillim e kurrikulave në disiplinën e Marketingut. ndërkombëtarizimin dhe përvetësimi i praktikave të mira evropiane dhe atyre globale të kurrikulës janë vendosur si objektiva strategjike si për DMT ashtu dhe ato që lidhen direkt me këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 3 Strategjia e Zhvillimit UT (2018-2023)</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizëm 2020-2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i Programit Master i Shkencave në Marketing</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3</p> <p>Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master Shkencor Marketing, janë të përcaktuara qartë objektivat formuese të cilat synojnë:</p> <p>a) të pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara në të kanaleve marketing dhe rolin e tyre integruar në menaxhimin e marketingut;</p> <p>b) të inkurajojë zbatimin e teorive të kanaleve të marketingut në një botë reale të administrimit të kanaleve të marketingut;</p> <p>c) të aftësojë studentët në aplikimin e teknikave të kërkimit në terren për të marrë vendime më efektive të marketingut dhe menaxhimit;</p> <p>d) të aftësojë studentët në realizimin e një procesi korrekt të kërkimit shkencor;</p> <p>e) të pajisë të diplomuarit me njohuri specifike në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve marketing që do të rezultojnë në ndërtimin e markave të forta etj.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing, neni 5 Misioni dhe Objektivat</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e</p>	<p>DMT ka dorëzuar për këtë program studimi një dokument në të cilin ka paraqitur katër kërkime të realizuara nga stafi i departamentit. Në këto</p>

<p>ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>kërkime reflektohet nevoja e vazhdueshme për të kuptuar tregun e punës. Megjithatë duhet thënë që kërkimet lidhen me shumë me zgjedhjen e universitetit, me analizën e tregut dhe evolucionin e tij si në situata normale (deri në vitin 2015) por edhe në situata të jashtëzakonshme (si Pandemia Covid 19). GVJ vlerëson që IAL nuk ka evidentuar konkretisht kompetenca dhe aftësi që lidhen direkt me Masterin Shkencor Marketing. Kështu nevojitet një përmirësim i tij jo vetëm në drejtim të identifikimit të kompetencave konkrete por edhe në shtrirjen e studimit të tregut në një përfaqësim më të gjerë aktorësh. IAL disponon të gjitha mundësitë si nga këndvështrimi metodologjik por edhe në drejtim të rrjetit të aktorëve që akseson nëpërmjet bordeve të punës.</p> <p>Për sa më sipër GVJ i sugjeron departamentit të hartojë një analizë më të plotë të tregut punës për programin e studimit MSh në “Marketing”.</p> <p><i>Evidenca 1.10 Studime të tregut të punës Departamenti Marketing-Turizëm</i></p> <p><i>Evidenca 1.11 Studimi i tregut të punës në ciklin e studimit Master i Shkencave Marketing</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga DMT mbi programin e studimit, rezulton se ai synon të kontribuojë në përgatitjen e specialistëve të aftë në Marketing. Programi i studimit zhvillohet në dy vite. Në vitin e parë të diplomuarit realizojnë 64 kredite të shpërndara në 11 lëndë, dhe zhvillojnë lëndët që vijon: Metoda kërkimi, Sjellje konsumatore, Marketing sipërmarrës, Drejtim i kanaleve marketing, Komunikimi Marketing, Menaxhimi i shitjeve, Kërkim i aplikuar i tregut, Strategjia Marketing, Marketingu i institucioneve, Menaxhimi i marrëdhënieve me klientët dhe Marketing ndërkombëtar. Në vitin e dytë, studentët pajisen me 56 kredite, nga këto, 30 kredite janë të alokuara në praktikën profesionale (12ETC) dhe Mikrotezë (18 ETC). Lëndët bazë të cilat kanë për objektivi të përgatisin studentët nga ana metodologjike përbëjnë 10% të krediteve të programit të studimit. Megjithëse, ky komponent mësimor është në përputhje me VKM nr 41-datë24.1.2018, GVJ vlerëson që lënda Menaxhim i Marrëdhënieve me Klientin mund të zhvendoset në kategorinë B si lëndë karakterizuese dhe lënda Kërkim tregu i Aplikuar të zhvendoset në kategorinë A sepse përgatit studentët nga ana metodologjike. Lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmblylëse janë konform VKM nr 41.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Marketing, neni 5 Misioni dhe Objektivat</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e</p>	<p>Programi i studimit - në strukturë, organizim dhe përmbajtje – është i krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara në IAL në shtete të tjera të Bashkimit Evropian dhe me gjerë. Për më tepër programi i studimit ofrohet me ECTS dhe në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e zonës evropiane të arsimit të lartë. IAL ka paraqitur të uniformizuar përmbajtjen e lëndëve në përputhje me VKM nr 41 dhe</p>

<p>studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>janë bërë përpjekje për të përditësuar literaturën e cila është në ndryshim të vazhdueshëm duke pasur parasysh fushën që mbulon programi i studimit. <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit nuk ka lidhje me profesionet e rregulluara dhe ndjek udhëzimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë të cilat, në shumicën e rasteve, janë të inkuorporuara në legjislacionin vendas për arsye që janë përmendur më sipër si psh transferimi i studimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Në programin e studimit parashikohet praktikë profesionale e cila përbën 10% (12 ECTS) të programit të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër, FE/ DMT mbështet studentët duke ofruar një listë institucionesh partnere për realizimin e praktikave. Nga takimi me studentët rezultoi se praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte të ndryshme, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Gjithashtu studentët që punojnë e zhvillojnë praktikën në vendin e tyre të punës. Praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte private apo publike në funksion të objektivave të këtij programi dhe nën drejtimin e personelit akademik të caktuar për këtë qëllim.</p> <p>Në fund të praktikës studentët platësojnë një dokument më të gjitha veprimtaritë që ata kanë realizuar dhe marrin vlerësimin përkatës.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Marketing, neni 5 Misioni dhe Objektivat, Takimi me studentët)</i></p> <p><i>Evidenca 2.18. Lista e marrëveshjeve për realizimin e praktikave profesionale</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.2 Memorandum Bashkëpunimi mes KM dhe FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.4 Lista e institucioneve/kompanive në të cilat studentët e Masterit Shkencor në Marketing kanë zhvilluar praktikën 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 2.11 Dosja e dokumentave të praktikës mësimore</i></p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në Marketing ofrohet në gjuhën shqipe. Megjithatë në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe transferimit të studimeve, njësitë bazë ka vënë në dispozicion të palëve të interesuara syllabuset e lëndëve edhe në gjuhën angleze. Programet mësimore në anglisht i shërbejnë studentëve në rast transferimi studimesh jashtë shtetit. Po kështu nga konsultimi i CV-ve të stafit të angazhuar në programin e studimit, vihet re një potencial i konsiderueshëm për ta ofruar këtë program studimi në gjuhën angleze. Ofrimi i programit në gjuhën angleze i krijon mundësinë studentëve që e ndjekin atë të punësohen me lehtësi në institucione vendase, por edhe të huaja të cilat operojnë në fushën e Marketingut. Në raportin e vlerësimit të brendshëm, paraqitet që Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Tiranës</p>

	(FEUT) iu ofron mundësinë studentëve të ciklit të parë të zgjedhin për ti zhvilluar studimet në gjuhën angleze ose shqipe dhe DMT është duke menduar për ta shtrirë këtë praktikë edhe në programet e studimit të ciklit të dytë. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing"</i> <i>Evidenca 2.1. 1Plani mësimor i programit të studimit në anglisht</i> <i>Evidenca 2.6.1 Programet e lëndëve në anglisht</i> <i>Evidenca 2.7.1 CV-të e personelit akademik</i>								
Kriteri 8. Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Dokumentacioni për këtë program studimi është në gjuhën shqipe ashtu sikurse ofrohet. Dokumentacioni që ka lidhje me ndërkombëtarizimin – aplikime, leksione të përbashkëta, etj. – është në gjuhën angleze. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing"</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	IAL, FEUT ka një përvojë të gjatë mbi 65 vjeçare në ofrimin e studimeve universitare në fushën e ekonomisë, financës, kontabilitetit, menaxhimit dhe marketingut. IAL ka krijuar struktura ndihmëse, këshilluese, monitoruese (KSBC) për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ndërkohë, programi i studimit Master Shkencor në Marketing organizohet dhe menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS) i cili përbëhet nga 3 anëtarë të zgjedhur nga përgjegjësi i departamentit. Drejtuesi i KPS është gjithashtu dhe koordinatori i programit të studimit. GVJ e vlerëson pozitivisht praninë e koordinatorit të programit të studimit i cili përfaqëson një person të dedikuar që bashkëpunon dhe koordinon të gjitha aktivitetet që lidhen me programin e studimit me strukturat e tjera përgjegjëse. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing (neni 7, neni 8)</i> <i>Evidenca 2.7.1 CV-të e personelit akademik</i> <i>Evidenca 1.8.1. Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike	Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik dhe njësisë bazë të FEUT. Ofrimi i programit të studimit është tërësisht në përputhje me fushën akademike dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 11

<p>e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>kërkimore të njësisë kryesore. Gjithashtu, ky program është në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, me Statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UT-së.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i ri UT</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing"</i></p>								
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Gjithashtu fusha e përgjithshme është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të DMT, i cili është përgjegjës për programin e studimit. Ky program studimi i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe bazohet në standardet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i ri UT</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing"</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="571 1037 790 1158"></td> <td data-bbox="790 1037 1008 1158">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1008 1037 1227 1158">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1227 1037 1426 1158">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td align="center">X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga pikëpamja rregullatore, UT ka miratuar statutin e tij ku sanksionohen njësitë ndihmëse pranë rektoratit si</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Struktura e programeve mësimore dhe e sigurimit të cilësisë ✓ Struktura e marrëdhënieve me jashtë dhe studentët ✓ Struktura e kërkimit shkencor dhe IT-së ✓ Struktura juridike dhe e marrëdhënieve me publikun ✓ Struktura e burimeve njerëzore dhe protokollit <p>Si edhe pozicioni i njësisë kryesore njësisë bazë, grupet mësimore kërkimore brenda dhe midis departamenteve etj. Gjithashtu, në bashkëpunim me rektoratin e UT, FE ka vënë në jetë procedurat e kontrollit të brendshëm të cilësisë të cilat janë në institucionalizim e sipër (<i>Neni 12,14,19, 42,46,47 Statuti UT</i>).</p> <p>Po kështu, secili prej pedagogëve të angazhuar në programin e studimit në fund të vitit akademik plotëson formularin për aktivitetin akademik</p>

	<p>dhe profesional dhe dorëzon një plan për vitin e ri. Ky dokumentacion përbën bazën vlerësimit të punës, ndarjes së detyrave dhe planifikimit të veprimtarive.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i ri UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Marketing"</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>FEUT ka bashkëpunime me institucione/ kompani publike për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në fushën e ekonomisë, financave dhe e marketingut. Organizatat/ institucionët 37 syresh, i përkasin sektorit publik, privat, sektorit financiar etj.</p> <p>Përsa i përket marrëdhënieve me jashtë, UT, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus Mobility me rreth 40 Universitete në BE si dhe jashtë saj. Gjithashtu UT ka nënshkruar në kuadër të programit MEVLANA exchange, marrëveshje me universitetet Turke si Universiteti Barti, kryesisht për shkëmbime stafi dhe studentësh.</p> <p><i>Evidenca 2.18 Marrëveshje Institucionale UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.2 Lista e marrëveshjeve FEUT për realizimin e Praktikave Profesionale</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.2 Marrëveshje Bashkëpunimi mes Këshillit të Ministrave dhe FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.3 Memorandum bashkëpunimi midis FEUT dhe Balfin Group</i></p> <p><i>Evidenca 2.19 Lista e institucioneve dhe kompanive në të cilat studentët e Masterit shkencor Marketing kanë zhvilluar praktikat viti 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Siç është përmendur me sipër, institucioni ka bashkëpunime të strukturuar me institucione publike qëndrore kryesisht për zbatimin e praktikave studentore por edhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta. Këto bashkëpunime lehtësohen nga fakti që disa nga lektorët e programit vijnë nga bota profesionale dhe administrata publike ku kanë mbajtur pozicione drejtuese. Një tjetër element që e lehtëson, punën e institucionit, është se shumica e studentëve të programit janë të punësuar, para se të regjistroheshin në program.</p> <p><i>Evidenca 2.18 Marrëveshje Institucionale UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.2 Lista e marrëveshjeve FEUT për realizimin e Praktikave Profesionale</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.2 Marrëveshje Bashkëpunimi mes Këshillit të Ministrave dhe FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.3 Memorandum bashkëpunimi midis FEUT dhe Balfin Group</i></p> <p><i>Evidenca 2.19 Lista e institucioneve dhe kompanive në të cilat studentët e Masterit shkencor Marketing kanë zhvilluar praktikat viti 2021-2022</i></p> <p><i>Ref. Takimi me studentët</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në tërësi përgjigja më sipër mbulon edhe këtë kriter pasi programi nuk ka ndonjë natyrë specifike që të kërkojë rregullime dhe marrëveshje të veçanta për kryerjen e praktikës.</p> <p><i>Evidenca 2.18 Marrëveshje Institucionale UT</i> <i>Evidenca 2.18.2 Lista e marrëveshjeve FEUT për realizimin e Praktikave Profesionale</i> <i>Evidenca 2.18.2 Marrëveshje Bashkëpunimi mes Këshillit të Ministrave dhe FEUT</i> <i>Evidenca 2.18.3 Memorandum bashkëpunimi midis FEUT dhe Balfin Group</i> <i>Evidenca 2.19 Lista e institucioneve dhe kompanive në të cilat studentët e Masterit shkencor Marketing kanë zhvilluar praktikat viti 2021-2022</i> <i>Ref. Takimi me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi me stafin e përfshirë në zyrën e projekteve në FEUT u evidentuan mundësitë e përfshirjes së stafit në programe dhe projekte të ndryshme kombëtare (AKSHI) dhe ndërkombëtare, Jean Monnet, Erasmus Plus Capacity Building të cilat nuk kanë vetëm si objektivat mobilitetet por edhe kërkimin shkencor. Nga konsultimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, vihet re se projektet kanë në fokus: Kërkim, Ekselencë, dhe Inovacion. Më konkretisht në DMT në Prill 2022 u bë aktive Qendra për Inovacion, Sipërmarrje në Marketing dhe Turizëm e financuar nga fondet e BE, <i>BLUEËBC, Sustainable Development Of Blue Economies Through Higher Education And Innovation In Eastern Balkan Countries</i>. Qendra ka për qëllim ndër të tjera të përmirësojë kërkimin shkencor dhe të aplikojë njohuritë teorike në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive sipërmarrëse në marketing dhe inovacion. Po kështu qendra shërben edhe për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve. Pajisja me fjalën e fundit në teknologji sa i përket analizës së sjelljes konsumatore përbën një praktikë të mirë për programin e studimit MSc Marketing.</p> <p>Gjithashtu vlen të përmendet që IAL vë në dispozicion të stafit një guidë për thirrje të reja projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 2.20 Projektet FEUT Përfshirja e stafit të Dep Marketing Turizëm në nivel kombëtar e ndërkombëtar</i> <i>Evidenca 2.23. Thirrje për projekte 2022</i> <i>Evidenca 2.24 Thirrje për projekte 2021</i> <i>Evidenca 2.25 Qendra Inovacionit Marketing Turizëm</i></p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga vizita në institucion, u vu re se DMT nuk ka një praktikë të veçantë në këtë kuadër</i>, por paraqet raporte të cilat evidentojnë tregues si: studenti, pedagogu udhëheqës, kompania , drejtoria apo struktura në të cilën zhvillohet praktika. Po kështu në kuadër të mobiliteteve të studentëve paraqiten informacione mbi studentët dhe universitetin e huaj ku zhvillohet mobiliteti. GVJ rekomandon pajisjen me një praktikë të raportimit të përfitimeve të studentit nga praktika profesionale në drejtim të kompetencave të reja të fituara dhe pse jo edhe evidentim të kompetencave të reja ta cilat mund ti shërbejnë si indicie të evolimit të tregut të punës.</p>

	Raportet e praktikës që mbrohen nga studentët janë një bazë e mirë për të hartuar një analizë përmbledhëse. <i>Evidenca 2.18 Marrëveshje Institucionale UT</i> <i>Evidenca 2.18.2 Lista e marrëveshjeve FEUT për realizimin e Praktikave Profesionale</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	<p>Personeli akademik inkurajohet të publikojë artikuj dhe punime shkencore me cilësi në përmbushje të kërkesave të VKM 112. Në vitin 2021, Senati Akademik i UT, miratoi vendimin Nr 28 datë 22.07.2021 për miratimin e programit të grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi shkencor në konferenca ndërkombëtare. Në këtë vendim detajohen: Qëllimi i programit të grantit, i cili duhet të jetë në përputhje me Planin e Kërkimit Shkencor të UT për vitet 2018-2022, kriteret e pranimit, dokumentat mbështetëse, procedurat e miratimit si dhe kostot e pranueshme për t'u rimbursuar. Po kështu UT ka paraqitur Vendimin nr 11 datë 26.04.2018 "Për miratimin e planit kërkimor të kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës për periudhën 2018-2022".</p> <p>Plani strategjik i kërkimit shkencor të UT-së shërben si një udhëzues për vendimarrjen lidhur me iniciativat institucionale, shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore sipas prioriteteve të zhvillimit të institucionit.</p> <p>UT dhe FEUT organizojnë konferenca vjetore si një mënyrë për të transferuar dhe shpërndarë rezultatet e kërkimit shkencor. Punimet shkencore janë publikuar në revistën shkencore "Revista Shqiptare Social Ekonomike" me ISSN dhe printed. Pjesëmarrja në projekte të ndryshme gjithashtu është një mënyrë për të mbështetur stafin në realizimin e kërkimit shkencor në bashkëpunim me kërkues të huaj. UT dhe FEUT në faqen e vet të ëeb por edhe në komunikimet të ndryshme në njësitë kryesore dhe bazë vënë në dispozicion të stafit informacione mbi Thirrje Projektesh në kuader të programit UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion 2021-2022. Për vitin 2022 ka qënë e hapur deri në datën 28 tetor (https://unitir.edu.al/projekte/).</p> <p><i>Evidenca 1.6. Plani i kërkimit shkencor UT 2018-2020</i></p> <p><i>Evidenca 1.13 Programi i grantit për prezantime në konferenca shkencore</i></p> <p>https://feut.edu.al/konferenca-botime/revista-shkencore/49-ajeb</p> <p>https://unitir.edu.al/botime-dhe-revista-shkencore/</p> <p><i>Revista Shqiptare Social Ekonomike, ISSN PRINT 2222-5846 dhe ISSN Online 2312-5349</i></p>


<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Rezultatet e punës kërkimore analizohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore kryesisht në fund të semestrit dhe vitit akademik. Puna kërkimore konsiderohet si pjesë e ngarkesës akademike të detyrueshme dhe në manualin e vlerësimit të performancës, kontributi në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) kërkim dhe veprimtari krijuese, 2) pjesëmarrje në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, 3) konferenca, seminare, kongrese, 4) workshope, 5) krijimtari artistike etj, 6) publikim monografish, 7) artikujsh e punimesh shkencore të natyrave të ndryshme në periodikë apo serial botimesh shkencore jo periodikë me komitet shkencor vlerësuese drejtues, pjesëmarrje në borde revistash, udhëheqje programesh doktorale etj. <p>Në manual në pikën 8.2, faqja 16 paraqiten edhe treguesit e matjes së performancës së kërkimit shkencor nga ana sasiore dhe cilësore, si pësh numri i artikujve dhe numri i citimeve.</p> <p>GVJ rekomandon që raportimi i treguesve sasiore dhe cilësore të bëhet konform këtyre kriterëve. Për shembull, DMT ka vënë në dispozicion konferencat dhe artikujt e publikuar nga stafi i angazhuar në departament dhe në programin e studimit por nuk detajohet qartë se cili është numri i artikujve i botuar në revista të Clarivate Analytics dhe Scopus si dhe numri i citimeve respektive. Këto të fundit janë tregues reale të cilësisë së publikimeve dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor dhe për rrjedhojë të personelit akademik.</p> <p>Rekomandimi i GVJ është edhe pjesë e Planit Strategjik të programit të studimit Msc në Marketing, pika 5.2.2 për Kërkimin Shkencor ku paraqiten prioritetet e kërkimit shkencor po si u tha më sipër në këtë plan strategjik duhen shprehur në mënyre eksplicite, citimet dhe cilësia e revistave.</p> <p>Nga GVJ shihet si pozitiv që DMT ka vendosur si prioritet realizimin e kërkimit në funksion të syllabuseve të lëndëve që mbulon stafi i angazhuar ne programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 3.8 Manuali i Vlerësimit të Përformancës të Personelit Akademik të UT</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.5 Formular i vlerësimit të personelit akademik</i></p> <p><i>Evidenca 6.5.2 Raporti Vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020</i></p> <p><i>Evidenca 6.5.1 Raporti Vjetor i Departamentit viti akademik 2020-2021</i></p> <p><i>Evidenca 6.5 Raporti Vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, FEUT publikon punimet akademike si dhe ‘proceedings’ të konferencave shkencore që realizon vet. Gjithësesi një punë më e mirë mund të bëhet për ‘outreach’ dhe krijimin e një profili publik të stafit duke e nxitur atë të aktivizohet në platforma të promovimit të kërkimit shkencor si Research gate, Scopus, Google scholar etj. Bazuar në ligjin nr 80/2015 datë 17/09/2015 “Për Arsimin e</p>

	<p>Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në VKM-në 112, dt,23.02.2018 për fitimin e gradës shkencore Doktor dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademike, Profesor i Asociuar dhe Profesor, promovimi i tyre në outletet e përmendura më sipër do të rrisë jo vetëm transparencën por do ndikojë edhe në rankimin e IAL.</p> <p><i>Evidenca 3.8 Manuali i Vlerësimit të Përformancës të Personelit Akademik të UT</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.5 Formular i vlerësimit të personelit akademik</i></p> <p><i>Evidenca 6.5.2 Raporti Vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020</i></p> <p><i>Evidenca 6.5.1 Raporti Vjetor i Departamentit viti akademik 2020-2021</i></p> <p><i>Evidenca 6.5 Raporti Vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 1.6. Plani i kërkimit shkencor UT 2018-2020</i></p> <p><i>Evidenca 1.13 Programi i grantit për prezantime në konferenca shkencore</i></p> <p>https://feut.edu.al/konferenca-botime/revista-shkencore/49-ajeb</p> <p>https://unitir.edu.al/botime-dhe-revista-shkencore/</p> <p><i>Revista Shqiptare Social Ekonomike, ISSN PRINT 2222-5846 dhe ISSN Online 2312-5349</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Në lidhje me kriterin 4 institucioni ndjek politikën e IAL. Ndiqet statuti i UT dhe ligji.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i RI i UT me shkresë</i></p> <p><i>Evidenca 1.20. Kodi i etikës</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Studentët janë përfshirë në punën kërkimore dhe kanë marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga FEUT (Ref Konferenca Studentore të FEUT 2018-2022. Megjithatë nuk u vu re ndonjë artikull në bashkë-autorësi me studentë. Në lidhje me këtë aspekt mendojmë që më shumë mund të bëhet për inkurajimin dhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor bashkë me pedagogët.</p> <p><i>Evidenca Konferenca Studentore të FEUT 2018-2022 te evidenca 2.22 Puna kërkimore-shkencore 2018-2022</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="561 1451 758 1541">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="758 1451 986 1541">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="986 1451 1220 1541">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1220 1451 1439 1541">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="561 1541 758 1581"></td> <td data-bbox="758 1541 986 1581"></td> <td data-bbox="986 1541 1220 1581">X</td> <td data-bbox="1220 1541 1439 1581"></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Marketing” e përmbush kriterin 1 pasi është program i ciklit të dytë i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma master i shkencave. Si është përmendur edhe më sipër, programi ka 120 ECTS, zhvillohet në dy vite akademike të ndarë në 4 semestra dhe zbaton përcaktimet e ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” me nenet përkatëse si dhe VKM nr 41. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij duke reflektuar kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga MASR.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit master</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi synon të formojë studentë me njohuri të përgjithshme dhe specifike në fushën e Marketingut. Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të punësohen apo të vijnë në karrierën e tyre profesionale (pasi shumica janë të punësuar kur regjistrohen) kryesisht në kompani private. Si u përmend më sipër por edhe nga takimi me studentët e regjistruar në këtë program studimi, studentët kanë njohuri të përgjithshme nga lëndët e marketingut të marra gjatë studimeve të ciklit të parë, sidomos studentët që kanë përfunduar studimet bachelor në Administrim Biznes. Nëpërmjet programit të studimit Master Shkencor në Marketing, studentët thellojnë njohuritë në drejtim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kërkimit të aplikuar në marketing • Komunikimit të integruar • Sjelljes konsumatore • Marketing ndërkombëtar • Menaxhim strategjik Marke • Marketing i institucioneve • Marketingu i sipërmarrjeve • Menaxhimi i marrëdhënieve me klientin • Menaxhimi i shitjeve <p>Fusha e marketingut është një sfidë më vehte jo vetëm për kompanitë duke pasur parasysh ndryshimet teknologjike por edhe për të reflektuar këto ndryshime në programet e studimit. Studentët e regjistruar në këtë program studimi janë një mundësi e mirë për sugjeruar përmirësime në programin e studimit sidomos për ato kompetenca që nevojiten me ndryshimet në tregun global pas pandemisë.</p>



	<p>Gjithashtu programi i mundëson studentëve të cilët kanë interes të vijnë studimet e ciklit të tretë. Në vitin 2021-2022 janë përzgjedhur gjashtë studentë që janë diplomuar në MSc Marketing në studimet doktorale (<i>Evidenca 2.21 Studentë të programit të studimit MSHMR të përzgjedhur për ciklin e III të studimeve</i>).</p> <p>Lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit lidhen harmonikisht me objektivat formues të programit të studimit. Kur të zhvillohet një studim më i strukturuar i tregut të punës, siç sugjeruam më sipër, këto veprimtari dhe objektiva mund të rishikohen nën prizmin e të dhënave të përftuara.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit master</i></p> <p><i>Evidenca 2.21 Studentë të programit të studimit MSHMR të përzgjedhur për ciklin e III të studimeve</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi MSHMR synon të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara në marketing dhe aftësi menaxheriale në këtë drejtim Aftësojë studentët të formojnë pikëpamjet e tyre dhe të gjenerojnë analiza për menaxhimin eficient të aktiviteteve të marketingut; Pajisë të studentët me njohuri dhe aftësi metodologjike në marketing <p>Në tërësi lëndët dhe sylabuset reflektojnë mire këto objektiva në leximet që japin për studentët, detyrat përkatëse si dhe aktivitetet në klasë. Po kështu literatura në pjesën më të madhe është e pesë viteve të fundit duke mundësuar përditësimin e koncepteve në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit master</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Siç u shprehëm edhe më sipër, programi i studimit i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca teorike dhe praktike. Në tërësi, në këtë program studimi studentit i mundësohet përvetësimi i njohurive të thelluara dhe aftësimi profesional me qëllim përshtatjen, sa më shumë të jetë e mundur, nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të vendit por edhe më gjerë.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit master</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të</p>	<p>Programi i studimit është pjesë e ciklit të dytë të studimeve dhe përmban elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit në përputhje me kriteret e vendosura në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i></p>

përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	<p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit master</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program organizohet në module/lëndë me kredite ECTS dhe lëndët grupohen sipas VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 si vijon:</p> <p>A. Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme – 2 lëndë, 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve);</p> <p>B. Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik – 11 lëndë, 63 kredite ECTS (52.5 % e totalit të krediteve);</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje – 3 lëndë me zgjedhje, 15 kredite ECTS (12.5 % e totalit të krediteve);</p> <p>D. Lëndë plotësuese - praktikat profesionale – 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve të këtij programi);</p> <p>E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës – 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve).</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit master</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit e përmbush edhe kriterin 7 pasi ka 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 2 vite akademike sipas detyrimeve ligjore. Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës, kanë 18 kredite ECTS ose 15 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave e cila firmoset nga dekani i FE dhe Rektori i UT. Nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi u informuan për procedurën e caktimit të temës me pedagogun udhëheqës. Ky i fundit paraqet një listë me tema të mundshme dhe pasi studenti zgjedh. Pedagogu i dërgon strukturën e punimit. Nga vlerësimi i dosjes së dokumentacionit të paraqitur nga IAL, vihet re që studentëve iu mundësohet një udhëzues për përgatitjen e mikrotezes dhe elementëve përbërës të saj si dhe formati që duhet të ndjekë studenti në punimin e saj. GVJ rekomandon që krahas dy elementëve të përmendur më sipër, duhet që të krijohet edhe një praktikë institucionale në vlerësimin e temës së diplomës sa i përket pikëve për pjesë të caktuara të punimit shkencor. Si psh 20% e notës nga inovacioni i temës, 20% nga cilësia e kërkimit, 20% cilësia në rishikimin e literaturës etj. Një praktikë e tillë lehtëson procesin e vlerësimit dhe rrit transparencën e procesit.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i></p>

	<i>Evidenca 2.3 Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës Master Shkencor në Marketing</i>		
	<i>Evidenca 2.3.1 Format mikroteze Master i Shkencave</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.2
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Përsa i përket këtij kriteri, GVJ vë në dukje që njësia kryesore FE dhe njësia bazë DMT, për programin e studimit MSc në Marketing përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Organizimi i njësisë kryesore bazohet në legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, statutin e UT-së dhe aktet e tjera nën-ligjore. Aktualisht njësia kryesore, FE, përgjegjëse për programin e studimit Msc në Marketing përbëhet nga 6 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomiksit • Departamenti i Financës • Departamenti i Kontabilitetit • Departamenti i Marketing Turizëm • Departamenti i Menaxhimit • Departamenti i Statistikës dhe Informatikë e Zbatuar <p>DMT që është përgjegjës për programin e studimit Msc Marketing plotëson detyrime ligjore për raportin e stafit PAE/ PAK. Në total raporti i orëve që mbulojnë pedagogë PAE për vitin 2021-2022 është rreth 94% të ngarkesës totale të orëve të zhvilluara për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i RI UT me shkresë</i> <i>Evidenca 0.2 Aneks tabelat përmbledhëse_RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në program përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme me tituj akademik e grada shkencore. GVJ vëren se stafi akademik i përfshirë në realizimin e programit është me formimin e duhur, me grada e tituj dhe – bazuar në takimin me studentët – profesional e i disponueshëm.</p> <p>Kështu për vitin akademik 2021-2022 Departamenti i Marketing-Turizëm ka:</p> <p>20 PAE nga të cilët 9 mbajnë titullinë Profesor/Prof i Asociuar, 7 mbajnë titullin Dr dhe 4 janë kandidatë për Dr, pra 80% e stafit është me tituj dhe grada.</p> <p>35 PAK nga të cilët vetëm 4 janë me tituj e grada. Për vitin 2021-2022 stafi PAK mbulon vetëm 6% të ngarkesës me orë në programin e studimit, duke qënë në përputhje të plotë me rregullin 70/30. Nga takimi</p>

	<p>me stafin u përmend si pikë e fortë përbërja e ndryshme moshore dhe mirëkuptimi midis tyre.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i RI UT me shkresë</i></p> <p><i>Evidenca 0.2 Aneks tabelat përmbledhëse_RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Si u përmend edhe më sipër, bazuar në tabelat përmbledhëse të dorëzuara nga IAL, 80% e stafit akademik e angazhuar në programin e studimit Master Shkencor Marketing për vitin akademik 2021-2022 është me tituj e grada. Në vitin akademik 2020-2021 departamenti kishte angazhuar në total 19 PAE/ 30 PAK. 100% e personelit PAE me tituj dhe grada. Ndërkohë në vitin 2019-2020 , 16 PAE/ 22PAK edhe në këtë vit 100% e stafit të brendshëm është me tituj dhe grada.</p> <p>Në tërësi, GVJ vëren se DMT ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit. <i>Evidenca 0.2 Aneks tabelat përmbledhëse_RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FE si dhe njësitë bazë përbërëse të tij janë në përputhje me Statutin e UT i cili është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Si u përmend edhe më sipër FE përbëhet nga 6 njësi bazë . Në ndihmë të tyre është edhe administrata e fakultetit ashtu si parashikohet në statutin e UT-së.</p> <p><i>1.1 Statuti i RI UT me shkresë</i></p> <p><i>1.8 Organigrama</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Në përbërje të programit të studimit, si u përmend edhe më sipër një peshë të rëndësishme në numrin e krediteve zë praktika profesionale, me 12 ECTS. DMT ka përcaktuar për secilin student një mbikqyrës praktike brenda departamentit. Përpos një pedagogu nga DMT, studenti ka edhe një mbikqyrës praktike në institucionin ky kryen praktikën.</p> <p><i>Evidenca 2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezës dhe praktikës</i></p> <p><i>Evidenca 2.11 Dosja e dokumentave të praktikës</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Për programin e studimit është miratuar koordinatori i programit i cili në rastin e programit të studimit Msc në Marketing është drejtuesi i Këshillit të Programit të Studimit (KPS). Ky i fundit përbëhet nga 3 anëtarë të zgjedhur nga përgjegjësi i departamentit. Në rregulloren e programit të studimit, në nenin 7 dhe 8 përcaktohen detyrat e tij të cilat lidhen me organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve për mbarrëvajtjen e programit të studimit. GVJ e vlerëson këtë si një praktikë pozitive për cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing</i></p>
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit ka detyrat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbledh dhe drejton mbledhjet e KPS-së • Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit në përputhje me Statutin, rregulloren e UT dhe të DMT, • Siguron që dokumentacioni bazë i programit të studimit, plani mësimor, syllabuse të jenë të përditësuar në cdo fillim viti akademik

	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohet që materialet didaktike janë në dispozicion të studentëve • Bashkëpunon me përgjegjësin e departamentit për kryerje e analizës mësimore-kërkimore <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing neni 8</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>FE është njësi kryesore e UT, e cila është IAL më e vjetër dhe më e madhe në vend me struktura të institucionalizuara. Duke analizuar dokumentacionin e dërguar, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ vëren se DMT ka informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar ka:</p> <p>a) kreditet ECTS;</p> <p>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</p> <p>c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</p> <p>ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</p> <p>d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</p> <p>dh) planin mësimor;</p> <p>e) kuotat e pranimit;</p> <p>ë) programin lëndor;</p> <p>f) profilin e programit;</p> <p>g) diplomën dhe suplementin</p> <p>Për gjithë sa më sipër, GVJ vëren se kriteri 1 plotësohet.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing neni 8</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Si është jemi shprehur disa herë edhe më sipër, programi i studimit i përket ciklit të dytë dhe organizohet në lëndë me ECTS. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksione; seminare; punim esesh, detyrash apo projektsh; prezantime, provime; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; praktika profesionale.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing neni 8</i></p>

	<p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Si është analizuar më sipër ndarja e orëve mësimore në auditor në leksione e seminare përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit në bazë të krediteve sipas kriterëve të specifikuar në aktet nën ligjore. Në semestrin e parë studentët zhvillojnë në auditor 660 orë (64 ECTS), ndërsa në semestrin e dytë, 690 orë në total (56 ECTS). Në përfundim të studimeve studenti grumbullon 120 ECTS. Viti akademik zhvillohet në dy semestra me kohëzgjatje 15 javë çdo semestër.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing neni 8</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Si është analizuar më sipër, plani mësimor zbaton kriteret e vendosura në VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Në planin mësimor detajohen lëndët - të ndara sipas kategorive formuese si dhe në vite e semestra - dhe kreditet përkatëse. Plani detajon gjithashtu ngarkesën mësimore, orët në dhe jashtë auditorit, frekuentimin e lëndëve dhe vlerësimin e dijeve.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing, neni 10 Struktura e programit mësimor</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program ka detajuar në rregulloren e tij - bazuar në kriteret ligjore - dhe i ka publike, elementet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimit dhe transferimit. Kuotat dhe kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programin e studimit Master Shkencor në Marketing, bëhen me vendim të Senatit Akademik, mbështetur në propozimet e DMT, miratimin e FEUT-së, në përputhje me kuotat e akorduara nga ministria e arsimit. Në nenin 11 të rregullores së programit të studimit paraqiten në formë të detajuar kushtet e pranimit të studentëve në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing, Kreu 3, Pranimi i studentëve, neni 11 Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit</i> <i>Evidenca 2.12 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2022 Cikli II-të</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Kriteri 6 plotësohet pasi, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në IAL, programi ka syllabuset për secilën lëndë, për praktikatat, dhe seminarat. Për syllabuset dhe praktikatat respektohen formatet e miratuara për këtë qëllim në VKM nr. 41 datë 24.01.2018. Për mikrotezën dhe praktikën, DMT ka miratuar formatet dhe udhëzime specifike.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>

	<p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i> <i>Evidenca 2.81 Formati i diplomës MSHMR</i> <i>Evidenca 2.11 Dosja e dokumentave të praktikës</i> <i>Evidenca 2.3 Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës Master i Shkencave Marketing</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Institucionit i lejohej që deri në masën 20 % të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS, me miratim të Senatit të ndërmarrë ndryshime. IAL ka dokumentuar ndryshimet të cilat janë bërë për të qenë në përputhje me ligjin. IAL gjithashtu disponon një procedurë të institucionalizuar për përmirësimin e programit të studimit. Në të janë të përcaktuara se çfarë përfshihet në ndryshime deri në 20%. Ndër to përmendim ndryshime në shpërndarjen e krediteve sipas disiplinave përkatës, zëvendësim lëndësh, modifikim emri lënde pa ndërruar fokusin etj.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 1.25 Praktika mbi ndryshimet e pjeshme në Master i Shkencave Marketing</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.⁴ Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/ “Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Si e kemi përmendur më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018. Në tërësi, GVJ vëren se organizmi dhe zhvillimi i programit dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore ETCS i mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit dhe përfitim aftësive profesionale.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vëren se emërtimi i programit është i përshtatshëm me përmbajtjen dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktika mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe aftësimin e studentëve në studimet evropiane. Siç kemi thënë edhe më sipër lëndët e programit dhe syllabuset janë të krahasueshme me programe të ngjashme në BE dhe i ofrojnë studentëve mundësinë të fitojnë aftësi përmbajtësore dhe të vazhdojnë më tej studimet në ciklin e tretë.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>

<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ vëren, siç ka vërejtur edhe më sipër, që lëndët dhe shpërndarja e tyre i mundësojnë studentëve pajisjen dhe zbatimin në praktikë të aftësive metodologjike dhe njohurive teorike të cilat përdoren në projektet, detyrat e kursit si dhe në punimin e mikrotezes. Gjithashtu përfshirja e studentëve në projekte dhe në konferenca studentore është një element më shumë i aftësisë metodologjike në praktikë. Të gjitha këto lehtësojnë dhe mundësojnë integrimin e të diplomuarve në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i> <i>Evidenca 6.11 Raporti FEUT 2018-2022</i> <i>Evidenca 5.8 Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore-Blue ËBC</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ vëren se programi i studimit, në strukturë dhe përmbajtje, është i krahasueshëm me programe të ngjashme ndërkombëtare. Megjithatë GVJ rekomandon që krahas përmirësimit të metodologjisë së kërkimit të tregut për identifikimin e kompetencave aktuale dhe ato të ardhshme të hartohet dhe një analizë benchmarking ku të analizohen programe studimi të ngjashme në rajon BE dhe më gjerë të cilat janë përdorur si referencë për ndërtimin e programit të studimit. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit do t'i shërbejë IAL-së për të ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ vuri re se në leksione përdorej gjërësisht metoda 'case study' në leksion e cila mundësonte gërshetimin e teorisë me situatë praktike. Duke patur parasysh edhe faktin që një pjesë e konsiderueshme e studentëve kur regjistrohen janë të punësuar, kjo krijon mundësi edhe për diskutime dhe detyra të nivelit me praktik si dhe për identifikim kompetencash të reja që mund ti vijnë në ndihme KPS për përmirësime të vazhdueshme të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Çdo lëndë ka syllabusin në gjuhën shqipe dhe angleze. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, GVJ vëren se stafi bëjnë përpjekje për të pasuruar literaturën në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në analizën e kritereve 2,3,4,5 dhe 6 GVJ vëren se edhe kriteri 7 përmbushet pasi në tërësi është derivat i tyre. Nga analiza sidomos e sylabuseve, GVJ vëren se ka përputhje midis titullit të lëndës, objektivave, literaturës dhe instrumentave të vlerësimit. Të gjitha këto mundësojnë përfitimin e dijeve të një programi të ciklit të dytë.</p>

	<p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Sipas ligjit të arsimit të lartë, diplomimi nga një program MSh i jep mundësinë studentit, nëse plotëson kriteret e tjera, të vijojë studimet e ciklit të tretë. Ky program studimi duke ofruar edhe trajnim të avancuar në metoda kërkimi dhe duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë. Përsa i përket tregut të punës, studentët mund të punësohen në sektorin privat por nuk përjashtohet edhe sektori publik.</p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i> <i>Evidenca 2.21 Studentë të programit të studimit MSHMR të përzgjedhur për ciklin e tretë të studimeve</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>FEUT ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, të sektorit publik dhe privat. Nga bashkëpunimi me to, në mënyrë kryesisht <i>ad hoc</i>, mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit dhe nevojave të tregut të punës. Por, siç e kemi thënë më sipër, duhet bërë një studim më i strukturuar i tregut të punës i cili gjithashtu të institucionalizojë në tej marrëdhënien me aktorët e tregut të punës. Institucionalizimi i metodologjisë së tregut të punës me partnerët me të cilët IAL ka marrëveshje mund të shërbejë si një pooling i frytshëm për identifikimin e kompetencave dhe nevojave të tyre. Kjo do ta ndihmojë IAL të zhvillojë dhe praktikën e analizës së rezultateve nga marrëveshjet midis palëve.</p> <p><i>Evidenca 2.18 Marrëveshje Institucionale UT</i> <i>Evidenca 2.18.1 Lista e marrëveshjeve FEUT për realizimin e Praktikave Profesionale</i></p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Si u përmend edhe më sipër, GVJ vëren se në tërësi kriteri 10 plotësohet. Specifikisht, GVJ vëren se programi i studimit duke ofruar trajnim të avancuar në metoda kërkimi dhe duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme,

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423



Web site: www.ascal.al



Faqe 27

që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Po aq e rëndësishme, stafi akademik në këtë program studimi angazhohet në proceset e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe gjithë elementëve e tjerë të programit të studimit. Pjesa kryesore e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë PAE i FEUT Referuar të dhënave rezulton se ngarkesa mësimore mbulohet nga stafi akademik PAE mbi masën 85%-90%, në të tre vitet që në disponojmë të dhënat. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me personelin si dhe takimi me studentët, GVJ vëren se kriteri 2 plotësohet. Personeli akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, me tituj dhe grada shkencore, dhe të gjithë janë me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe në kërkim shkencor. Por si u përmend më sipër duhen bërë më shumë përpjekje për përfshirje të stafit në platforma si Research gate, Scopus, etj. Bazuar në të dhënave për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa mësimore e stafit të angazhuar në këtë program studimi varion nga 60 - 420 orë, në të gjitha programet mësimore ku stafi është i angazhuar. Numri i lëndëve që ata mbulojnë është 2, 3 ose 4 dhe janë përputhje me fushën e tyre të studimit. GVJ vëren se mbulimi i ngarkesës mësimore dhe norma përkatëse respekton raportin PAE/PAK bazuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR (sqsuar më sipër).

Bazuar në të dhënat tabelore të dërguar nga IAL reulton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka pasur kualifikimin si më poshtë:

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	6	-	5	-	5	-
Prof.Assoc	4	-	4	-	4	-
Dr/Doc	4	-	4	-	5	-
Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	-	-
Msc	1	2	-	1	-	-
Në total	15	2	13	1	14	0

Në këtë program studimi angazhohen staf i kualifikuar me tituj dhe grada në përputhje me kriteret ligjore.

Aneks RVB-Tabela përmbledhëse

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit

GVJ vëren se kriteri 3 plotësohet, fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. Siç u

<p>akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>shprehëm më sipër, eksperiencia akademike ndërthuret mirë edhe me atë profesionale duke e shtuar gamën e informacionit që ofrohet për studentin.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve syllabuset</i> <i>Evidenca 2.7 CV e personelit akademik efektiv shqip dhe anglisht</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Si u përmend edhe më sipër, GVJ vëren se departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës e cila zhvillohet në institucione me të cilat FEUT ka marrëveshje bashkëpunimi. E njejta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada pedagog PAE të FEUT-DMT. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga Udhëzuesi për përgatitjen dhe mbrojtjen e mikrotezës (referuar më sipër).</p> <p><i>Evidenca 2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezave dhe praktikave MSHMR</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>GVJ vëren se ky program studimi nuk ka orë laboratorike e laboratorë të dedikuar pasi ka natyrë teorike. Gjithësesi, GVJ dëshiron të vërë në dukje, bazuar në vizitën në institucion, se në IAL, me mbështetjen e projektit BLUEËBC, është krijuar qendra e Inovacionit dhe Sipërnarrjes në Turizëm. Kjo qendër u mundëson studentëve të DMT të zbatojnë në praktikë njohuritë teorike të marra gjatë studimeve kryesisht në drejtim të inovacionit dhe sipërmarrjes. Gjithashtu, stafi i angazhuar në këtë program studimi e përdor qendrën për të aplikuar kërkime multidisiplinare në sidomos në drejtim të turizmit dhe marketingut në turizëm. Pajisja me fjalën e fundit të teknologjisë në drejtim të neuroshkencës i jep mundësi studentëve të testojnë konsumatorin kur ai përballet me stimuj të ndryshëm marketingu.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>GVJ është shprehur edhe më sipër se përsa i përket anagazhimit me tregun e punës. Së pari, një pjesë e mirë e të diplomuarive në programin e studimit janë të punësuar dhe një pjesë e mirë kur regjistrohen janë të punësuar. Kjo është një pikë shumë e fortë e programit. <i>Megjithatë, dokumenti i tregut të punës si u analizua edhe më na ofron një përmbledhje të disa kërkimeve të stafit të angazhuar</i></p>

<p>bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p><i>në programin e studimit në drejtim të zgjedhjes së universitetit por jo një identifikim i mirëfilltë i aftësive dhe kompetencave të nevojitura. Po kështu nuk gjetëm evidenca të plota për angazhimin e partnerëve të tregut të punës në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit. GVJ thekson që ka komunikime midis palëve por mungon një proces i strukturuar në këtë drejtim prandaj duhet adresuar.</i></p> <p><i>Evidenca 1.10 Studime të tregut të punës Departamenti Marketing Turizëm</i></p> <p><i>Evidenca 1.11 Studime të tregut të punës në ciklin e studimit Master i shkencave Marketing</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se kriteri 2 plotësohet. Nga takimi me studentët u informuam se ato kishin një sërë instrumentash në dispozicion, formalë dhe informalë, për të dhënë mendimin e tyre për programin e studimit, literaturën në dispozicion si dhe qasjen didaktike.</p> <p><i>Evidenca (Takimi me studentët dhe 6.2.1 dhe 6.2.2 - Rregullore dhe manuali për Sigurimin e Cilësisë në UT).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet në institucion me përgjegjësit e zyrës së karrierës , GVJ u informua se, FEUT përpiqet të ruajë kontaktet me studentët e diplomuar dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Po kështu, IAL ka vënë në dispozicion të GVJ Rregulloren për Zyrën e karrierës. Në nenin 6 të kësaj rregulloreje është e institucionalizuar praktika e gjurmimit të studentëve para dhe pas diplomimi. Zyra e karrierës mban një databazë të marrëveshjeve me biznesin por edhe të Alumnit. Kjo zyrë mban marrëdhënie me të diplomuarit duke i ftuar ata në takime, projekte, vizita studimore dhe leksione të hapura. Po kështu kjo zyrë ofron dhe asistencë për studentët duke i ndihmuar në gjetjen e praktikës, përpilimit të letrës së motivimit, CV etj.</p> <p><i>Evidenca Takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe 5.9 Rregullore e zyrës së karrierës</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se FEUT ka shtuar përpjekjet për të përditësuar dhe përshtatur programet e studimit me kërkesat dhe nevojat e tregut dhe partnerëve të saj. Gjithësesi, ne nuk ishim në gjendje të identifikonim një zbatim të kësaj qasje deri në momentin e vizitës në institucion.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ vëren se DMT bazon punën kërkimore në Planin e Kërkimit Shkencor të UT (2018-2022) si dhe Strategjinë e Zhvillimit të UT (2018-2023). Programi ka objektiva të qarta që formësojnë dhe reflektohen në planin mësimor dhe sylabuset e lëndëve. Puna kërkimore në DMT shihet si mjet për të aplikuar njohuritë e marketingut në realitetin shqiptar. Pavarësisht situatës me fillimin e pandemisë, stafi akademik ka arritur të angazhohet në aktivitete shkencore dhe kërkimore (konferenca, botime, projekte, ekspertiza etj. <i>Evidenca 2.22 Puna kërkimore shkencore 2018-2022</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	GVJ vëren se drejtimet kryesore kërkimore të DMT dhe programit të studimit bazohen në <i>Planin e Kërkimit Shkencor të UT (2018-2022)</i> dhe <i>Planin Strategjik të DMT dhe Planit strategjik të programit të studimit</i> . Si është përmendur edhe më lart, FEUT ofron mbështetje stafit nëpërmjet grantit për prezantime në konferenca si dhe informon vazhdimisht për ti nxitur të përfshihen në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare. <i>Evidenca 1.6 Plani i kërkimit shkencor UT 2018-2022</i> <i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizëm</i> <i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i programit Master shkencor Marketing</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	GVJ vëren se ky program studimi synon të pajisë të diplomuarit me njohuri teorike e metodologjike që mundësojnë punën e pavarur kërkimore dhe integrimin në tregun e punës. Studentët e FEUT janë gjithashtu të përfshirë në një sërë shkëmbimesh në projekte Erasmus+ në mobilitet të zhvilluara në universite në Gjermani, Çeki, Suedi, Austri, Itali, Angli, Spanjë, Portugali, Greqi, Turqi, Luksemburg etj. Megjithatë do të ishte mirë të që të kishim një numër të detajuar të mobiliteteve që kanë zhvilluar konkretisht studentët që ndjekin programin e studimit në shqyrtim <i>Evidenca 2.14 Lista e studentëve që kanë kryer mobilitete</i>
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Ky program studimi duke qenë se është cikël i dytë MSH, fokusohet në përcimin e aftësive metodologjike dhe teorike për kërkim shkencor të aplikuar. Thuajse të gjitha lëndët përfshijnë kërkim të pavarur studentor të reflektuar në detyra kursi/ese. Gjithashtu programi ka edhe temën që duhet përmbyllur në fund të studimeve e cila përfaqëson një kërkim të thelluar shkencor të ngjashëm me shkrimet e artikujve shkencor. Në tërësi, GVJ rekomandon që studentët duhet të nxiten më shumë për të marrë pjesë në kërkime të përbashkëta me pedagogët duke iu krijuar kështu mundësinë vijimit të studimeve. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Msc Marketing</i>
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet	DMT/FE si pjesë e UT varet financiarisht nga UT pasi edhe të ardhurat që mund të gjenerojë vetë, bazuar në rregullat e thesarit të shtetit, administrohen në nivel qendror. Edhe UT, si institucionet e tjera

financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	publike të arsimit të lartë në Shqipëri, vuajnë nga financimi i pjesshëm i kërkimit shkencor pasi fondet janë të limituara. Megjithatë parashikimi i një granti për pjesëmarrje në konferenca si dhe përfshirja në projekte ndërkombëtare të cilat janë përmendur më sipër i ka mundësuar DMT të ketë output kërkimor dhe pse jo gjithmonë është i garantuar publikimi në revista në databazën SCOPUS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Siç e kemi thënë edhe më sipër, GVJ vëren se FEUT ka pjesëmarrje në rritje të partneriteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me aktorë me reputacion të lartë kërkimor si Jean Monnet Chair. Po kështu DMT ka zgjeruar bashkëpunimin me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare duke realizuar oponenca të projekteve, realizimin e studimeve dhe publikimeve të përbashkëta në kuadër të projekteve BlueEBC, INTERBA. <i>Evidenca 6.11 Raporti i FEUT 2021-2022</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga vizita në IAL u informuam për bashkëpunimin e FEUT me institucione publike dhe kompani private. Gjithashtu, nëpërmjet internshipeve, FEUT ndihmon institucionet publike dhe private me studentë ekselentë duke i mundësuar atyre që edhe të marrin eksperiencë. <i>Evidenca 6.11 Raporti i FEUT 2021-2022</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GVJ vëren se, FEUT-DMT ka zhvilluar aktivitete si: konferenca, leksione të hapura, seminare, forume dhe tryeza debati me të ftuar vendas apo të huaj ku kanë marrë pjesë stafi akademik dhe studentë të këtij program studimi. Po kështu shkëmbimet në kuadër të Erasmus Mobility forcojnë kontaktet dhe rrisin mundësinë e bashkëpunimit në projekte dhe aktivitete vendore dhe ndërkombëtare. <i>Evidenca 5.12 Tavolina diskutimi</i> <i>Evidenca 6.11 Raporti FEUT 2021-2022</i> <i>Evidenca 6.5.2 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca 2.26 Workshop dhe agjenda e Workshop</i> <i>Evidenca 2.19 Lista e konferencave të realizuara në periudhën 2018-2022</i> <i>Evidenca 2.16 Mobilitete të personelit akademik të huaj pedagogu pritës</i> <i>Evidenca 2.10 Leksione të hapura Open Air University`</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ vëren se IAL e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standartet e vendosura nga UT dhe ato shtetërore të cilësisë duke harmonizuar leksionet në kohë reale me ato të vëna në dispozicion nga pedagogu online. Në nivel institucional IAL-ja përdor sistemin Teams (LMS - Learning Management System), i cili i bën të mundur studentit në kohë reale të ketë qasje on-line me materialet e e përgatitura nga pedagogu si p.sh. leksione, materiale shitesë audiovizive, si dhe të kryejë vlerësimet për elementë të caktuar të mësimdhënies. Gjithashtu në nivel program-studimi UT ka vënë në dispozicion edhe udhëzuesin e pedagogut për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 3.2 Udhëzues i UT për mësimin në distancë</i> <i>Evidenca 3.4 Manual përdorimi Udhëzues Microsoft Teams</i> <i>Evidenca 4.11 Manual përdorimi E-student Pedagogët</i> <i>Evidenca 4.12 Portali E student llogari hyrëse si evidencë</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>FEUT konsideron se përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies mund të arrihet vetëm nëpërmjet operimit të mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të personelit akademik në mënyrë periodike. Vlerësimi kryhet nga</p> <p>i) studentët për elementët e mësimdhënies); ii) Monitorimin periodik të performances së personelit akademik dhe aftësive të mësimdhënies nga; iii) si dhe një formular i vetvlerësimit të punës mësimore dhe kërkimore.</p> <p>Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p><i>Evidenca 4. Ngarkesa vjetore e personelit akademik</i> <i>Evidenca 3.8 Manuali i vlerësimit të performancës të Personelit Akademik</i> <i>Evidenca 6.11 Raporti FEUT 2021-2022</i> <i>Evidenca 6.5.2 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Për të tërhequr mendimin e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve FEUT garanton përfshirjen e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në anketim për secilën lëndë të zhvilluar si dhe garantimin e ankimimit të rezultatit të provimit sipas procedurës së përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>Evidenca 6.2.4 Anketimi i NjSBC-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT e përditësuar</i></p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e siguruar nga këto vlerësime, NJSBC - si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, ku përfshihen dhe rezultati i punës së personelit ndihmës akademik - harton raportin vjetor me anë të të cilit informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UT rreth rezultateve të monitorimeve, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Megjithatë struktura e sapokrijuar ka ende mangësi në përmbushjen e të gjitha hapave të kriterit dhe ato zbatohen në nivel institucional dhe jo në nivelin e departamenti. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë njësi u tha se po punohet për të institucionalizuar të gjitha procedurat që lidhen me garantimin e cilësisë në të gjitha komponentët e programit të studimit. Hartimi i një plani pune nga ana e NJSBC-së dëshmon vullnetin e strukturave drejtuese në IAL për të përmirësuar këto procese.</p> <p><i>Evidenca 6.2.1 Manuali për sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidenca 6.1 Plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024</i> <i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i> <i>Evidenca 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Raportet e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik shërben për të evidentuar temat për organizimin e trainimeve specifike lidhur me nevojat e stafit të UT, por edhe përdoret si bazë për vlerësimin e performancës së stafit si kriter për zbatimin e marrëdhënieve të punësimit i.e. kohëzgjatja, apo shpërblimi. Rezultatet e marra diskutohen edhe në mbledhjet e departamentit edhe me pedagogët në mënyrë individuale në fund të vitit akademik kur kryhet vlerësimi i stafit akademik.</p> <p><i>(Takimi me zyrën e NJSBC, – 6.5Raporti Vjetor i Departamentit 2021-2021; E.18 – Manuali i Vlerësimit të Performancës).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>				

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Procesi i mësimdhënies dhe mësim nxënies harmonizon format tradicionale si leksionet, seminarat, apo detyrat e kursit, me projekte dhe praktikat profesionale duke mbajtur parasysh ngarkesën në orët mësimore të punës individuale dhe orëve në auditor.</p> <p><i>Evidenca 1.5 – Rregullore e Programit të Studimit MSH “Marketing”</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>

hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	
<p>Kriteri 2. Personeli akademik duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik përpiqet që të përzgjedhë format më efektive të mësimdhënies duke patur paraysh orën e mësimin, karakteristikat e lëndës, numrin dhe nivelin e mësimnxënies së studenteve, literaturën në dispozicion, si edhe kombinimin e aspektit teorik me atë praktik.</p> <p><i>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,</i> <i>Evidenca 1.5 – Rregullore e Programit të Studimit MSH “Marketing”</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UT mbështet personelin akademik në procesin e përmirësimit të mësimdhënies duke mundësuar përdorimin e mjeteve didaktike më të përshtatshme për tematikën e trajtuar përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe trajnimet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të paisura me mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, ndonëse vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p><i>Vëzhgimi i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.</i> <i>Evidenca Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023 pika 1-mësimdhënia dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ vlerëson që stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojën e duhur profesionale dhe akademike në shpjegimin/transmetimin e njohurive dhe koncepteve të cilat ofrohen nga ky program. Numri i PAE ka ardhur duke e rritur në dy vitet e fundit — nga 16 në vitin akademik 2019-2020, në 20 në vitin akademik 2021-2022. Kualifikimet dhe eksperiencat e përfutur brenda dhe jashtë institucionit, si dhe aplikimet në projekte kombëtare, ndihmojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e metodave didaktike të përdorura.</p> <p><i>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,</i> <i>Evidenca 1.5 – Rregullore e Programit të Studimit MSH “Marketing”</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 0.2 Aneks tabelat përmbledhëse_RVB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët</p>	<p>FEUT ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë qëllim shërben pyetësori i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatën e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Megjithatë procesi se si integrohen këto rezultate në</p>




<p>në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>kurrikulat e programit nuk është e qartë. Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga ana e NJSBC-së me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen. Vlen të theksohet se struktura aktuale e NJSBCS funksionon më shumë në nivel institucioni se në nivelin e njësisë bazë duke qenë se është një strukturë relativisht e re. Megjithatë si u përmend edhe më lart, hartimi i një plani nga IAL për aktivitetin monitorues të komponentëve të ndryshëm të programit të studimit përbën një hap pozitiv.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Manuali për sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidenca 6.1 Plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024</i> <i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i> <i>Evidenca 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nepermjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive. GVJ sugjeron që në fokus të vazhdueshëm duhet të mbahet përmirësimi i kurrikulave me informacione sa më të azhornuara duke patur parasysh se në Marketing literatura dhe kërkimi janë në evolucion të vazhdueshëm duke pasur parasysh zhvillimet në Inteligjencën artificiale dhe neuromarketing.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve,</i> <i>Takim me studentët e programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Personeli akademik gjatë leksioneve dhe seminareve alternon metoda të ndryshme të mesimdhënies për ti dhënë mundësi studenteve që të marrin pjesë në diskutime, të bëjnë analiza dhe të prezantojnë ato në mënyrë bindëse dhe të argumentuar. Në orët mësimore ofrohen për diskutim edhe shembuj dhe situata konkrete me qëllim që studentët të kenë mundësi të reflektojnë nëpërmjet aplikimit direkt kompetencat e zhvilluara si edhe të reflektojnë progresin e arritur në asimilin e programit Marredhenia mes pedagogeve dhe studentëve zhvillohet në respekt të rregullave të komunikimit dhe etikës institucionale</p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit,</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të Studimit Master shkencor Marketing</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Ambientet ku kryhet procesi mësimor plotësojnë standardet për të zhvilluar një mësimdhënie cilësore. Ambientet dhe dhe sallat mësimore kanë hapësirat e nevojshme. Për këto shërbime dhe mirëmbajtjen e ambienteve të institucionit kujdeset stafi administrativ i FEUT. Programi i studimit Master Shkencor në Marketing ka salla të dedikuara në katin e 5-të të godinës B. <i>Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.)</i> <i>Evidenca 3.10 Kapacitete infrastrukurore</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Procesi mësimor zhvillohet në ambientet e rikonstruara dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për të siguruar nje aktivitet akademik cilësor. Laboratorët janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Disa nga programet e instaluar janë apache, eclipse, Microsoft office, si dhe evieës, stata dhe spss për përpunime të ndryshme statistikore. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor dhe përfitojnë nga sistem Wireless <i>Evidenca 4.20 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Si është përmendur edhe më lart, në funksion të programit të studimit është ngritur Qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Marketing dhe Turizëm. Kjo qëndër ndër të tjera ka për qëllim krijimin e një ekosistemi për të nxitur bashkëpunimin midis universitetit, sektorit privat e atij publik si dhe studentëve. Pedagogët dhe studentët mund të komunikojne nëpërmjet sistemit informatik duke përdorur materialet online por edhe forumet e hapura ndërsa studentet mund ti kontrollojnë notat dhe materialin akademik online duke patur akses kudo që ndodhen. <i>Takim me studentët e programit të studimit dhe me sekretarinë mësimore, Evidenca 3.10 Kapacitete infrastrukurore.</i>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	E gjithë literatura bazë dhe ajo ndihmëse është vënë në dispozicion te studentëve si në formë fizike dhe digjitale. Ndërsa materialet kryesore mësimore të programit janë në gjuhën shqipe. Po ashtu ofrohet edhe mundësia për akses nga ana e studentëve e literaturës online dhe pa pagesë (e-library) duke i ofruar studentit mundësinë e shfrytëzimit të një databazë më të plotë dhe të azhornuar, duke kombinuar literaturën bazë të detyrueshme dhe atë te rekomanduar e cila përgatitet nga pedagogu i lëndës. Pasurimi vazhdueshëm i literaturës së vënë në dispozicion garanton marrjen e dijeve dhe



	<p>njohurive të nevojshme, si dhe kërkimin shkencor të parashikuara për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 4.14 Informacion nga Biblioteka e FEUT).</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës e pajisur me kompjutera dhe akses në internet. Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë. Çdo vit akademik, pedagogët mund të depozitojnë kërkesat e tyre për literaturën e nevojshme dhe mbështetëse të re për tu patur në bibliotekë. Po kështu, biblioteka në bashkëpunim me njësitë kryesore sipas procedurave të përcaktuara, përcakton kërkesat për blerje librash, për shtim titujsh apo edhe kopjesh.</p> <p><i>Evidenca 4.14.1 Lista e plotë e librave të bëra hyrje në bibliotekë në periudhën 2019-2021.</i></p> <p><i>Evidenca 4.16 Lista e librave në Bibliotekën e FEUT në funksion të programit Msc në Marketing.</i></p> <p><i>Evidenca 4.14.1 Lista e plotë e librave të bëra hyrje në bibliotekë në periudhën 2019-2021.</i></p> <p><i>Evidenca 4.18 Buxhet afatmesem,</i></p> <p><i>Vendim_i_Bordit_të_Administrimit_UT buxhet afatmesem 2020-2022</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Infrastruktura e bibliotekës por edhe bibliotekat online si: JSTOR, COBISS+, i ofrojnë studentëve dhe pedagogëve mundësi për të shfrytëzuar një database kërkimor më të gjerë, si edhe mundësojnë akses në literaturën më të fundit bashkëkohore në lidhje me tematikat e programit. Një info më e detajuar mbi sasinë dhe cilësinë e materialeve që mund të aksesohen online paraqitet fushën 4 të raportit.</p> <p><i>Evidenca 4.14.1 Lista e plotë e librave të bëra hyrje në bibliotekë në periudhën 2019-2021.</i></p> <p><i>Evidenca 4.16 Lista e librave në Bibliotekën e FEUT në funksion të programit Msc në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 4.15 Biblioteka FEUT_mjediset</i></p> <p><i>Evidenca 4.14 Informacion nga Biblioteka</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Siç është përmendur edhe më sipër në funksion të programit të studimit Master Shkencor në Marketing është krijuar qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Marketing Turizëm, pajisja e të cilës me teknologjinë moderne dhe infrastrukturën e nevojshme laboratorike, mundëson zhvillimin e detyrave të kursit, diplomave etj. Kjo qendër gjithashtu i jep mundësinë studentëve të zhvillojnë edhe kërkime inovatore në fushën e marketingut dhe neuroshkencës. Po kështu në dispozicion të studentëve janë edhe ambjente të tjera të FEUT. Kjo e fundit disponon 11 laboratore që shfrytëzohen edhe nga programe të tjera studimi. Orari i pershtatshëm i aksesit (8:30-20:30) për studentet që punojnë si dhe njohja paraprake e ambjenteve duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë perfunduar studimet në ciklin e parë në FE e rrit potencialisht</p>

	<p>perdorimin e ambjenteve nga studentet qe ndjekin programin e studimit ne shqyrtim.</p> <p><i>Evidenca 3.10 Kapacitetet infrastrukturore</i> <i>Evidenca 4.20.1 Infrastruktura ne funksion te programit</i> <i>Evidenca 4.20 Te dhena mbi kapacitetin e sallave dhe pajisjeve</i> <i>Evidenca 4.15 Biblioteka FEUT_mjediset</i> <i>Evidenca 4.14 Informacion nga Biblioteka FEUT</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Pandemia Covid 19 përpos problematikave tregoi ndër të tjera aftësinë e stafeve akademike për tu përshtatur me një mjedis të ri të zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Një nga elementet kryesore të këtij mjedisi janë dhe përdorimi i platformave online. Stafi i angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Marketing përdorën platforma si google classroom dhe MS Teams. Tashmë post pandemia la si legacy dhe përforcoi dhe përmirësoi përdorimin e vazhdueshëm të platformave, nëpërmjet të cilave ofrohen leksionet, materialet shtesë, vlerësimeve dhe kryesisht komunikimi ndërmjet pedagogëve. Për të rritur aksesin dhe cilësinë e këtij komunikimi janë përgatitur dhe shpërndarë edhe manuale për aksesin dhe përdorimin e platformave online, duke u përqendruar tek një ekspoze e metodave inovative në këtë drejtim- dhe po përmirësohet sistemi.</p> <p><i>Evidenca 3.2 Udhezues i UT per përdorimin e sistemit të mësimin në distance.pdf</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore Provimet në distance.pdf</i> <i>Evidenca 3.4 Manual perdorimi Udhezues Microsoft Teams.pdf</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët përdorin MS Teams edhe për komunikime të brendshme si vlerësimi, notat, kontakte sqaruese për detyrat, shpërndarjen e materialeve mësimore si dhe çdo komunikim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mësimore. Për këtë qëllim përdoren edhe adresat me domainin @unitr.edu.al</p> <p><i>Evidenca 3.2 Udhezues i UT per përdorimin e sistemit të mësimin në distance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës, kanë 18 kredite ECTS ose 15 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave e cila firmoset nga dekani i FE dhe Rektori i UT. Nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi u informuam për procedurën e caktimit të temës me pedagogun udhëheqës. Ky i fundit paraqet një listë me tema të mundshme dhe pasi studenti zgjedh. Pedagogu i dërgon strukturën e punimit. Nga vlerësimi i dosjes së dokumentacionit të paraqitur nga IAL, vihet re që studentëve iu mundësohet një udhëzues për përgatitjen e mikrotezes dhe elementëve përbërës të saj si dhe formati që duhet të ndjekë studenti në punimin e saj. Si u përmend edhe më sipër, GVJ vëren</p>


	<p>se departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikqyrjen e praktikës e cila zhvillohet në institucione me të cilat FEUT ka marrëveshje bashkëpunimi. E njejtja praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada pedagog PAE të FEUT-DMT. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga Udhëzuesi për përgatitjen dhe mbrojtjen e mikrotezës (referuar më sipër). Për mikrotezën, DMT ka miratuar formatin dhe udhëzime specifike.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i></p> <p><i>Evidenca 2.81 Formati i diplomës MSHMR</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezave dhe praktikave MSHMR</i></p> <p><i>Evidenca 2.3 Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës Master Shkencor në Marketing</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat e ngritura në nivel institucional merren me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë dhe drejtohen nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë (KPSC), i cili bashkërendon punën me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e kurrikulave dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Këto zyra janë përgjegjëse për hartimin e planeve dhe aktiviteteve të monitorimit, në lidhje me syllabuset e lëndëve, dokumentacionit për programet e studimit etj. Vihet re dhe nga lista e evidencave që IAL ka vënë në dispozicion se ka një qasje proaktive në këtë drejtim. Plani i veprimit për sigurimin e cilësisë e tregon me së miri këtë tendencë. Staf i angazhuar në NJSBC në nivel fakulteti pohoit që është një strukturë në zhvillim e sipër dhe se po bëhen të gjitha përpjekjet për ta ngritur atë sipas të gjitha standarteve të kërkuara për përmirësimin e cilësisë duke përdorur edhe eksperiencën nga IAL të tjera. GVJ rekomandon shtrirjen e proaktivitetit edhe në njësinë bazë që është përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca. Takim me stafin e angazhuar te NJSBC</i></p> <p><i>Evidenca 1.21 Vendim për Krijimin e NJSBC UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.27 Procedura për përmirësimin e programeve të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 3.5 Vendimi nr. 10 date 11.04.2019 për miratimin e komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë të UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.6 Vendimi nr. 11 date 11.04.2019 për miratimin e Komisionit të përhershëm të Kurrikulës.</i></p>

	<p><i>Evidenca 3.8 Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik të UT</i></p> <p><i>Evidenca 6.1 Plani i Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2021-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2 Vendim i SA, nr.51, datë 23.12.2020 Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.1 Manuali për sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.4 Anketimi NJSBC - Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve të studentëve</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.5 Formulari i vlerësimit nga personeli akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>DMT është njësia përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit Master Shkencor në “Marketing”. Për këtë qëllim grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel fakulteti harton një raport vjetor ku paraqiten analizat mbi cilësinë e programit dhe hapat që duhet të ndiqen për përmirësimin e tyre. Departamenti përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, garanton që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Silabuset e hartuara miratohen nga përgjegjësi i departamentit, i cili bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimin nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar. Stafit akademik dhe studentët janë në djeni të procedurave të vlerësimit të mësimdhënies, duke rritur vetëdijen e tyre për cilësinë e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca Takim me drejtuesit DMT</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të Studimit MSc Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.4 Anketimi NJSBC - Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve të studentëve</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.5 Formulari i vlerësimit nga personeli akademik</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>DMT dhe strukturat ndihmëse në nivel UT mbështesin zbatimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies duke përdorur më gjerësisht nga fillimi i vitit teknologjinë informative si LMS. Po kështu qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Marketing Turizëm, i jep mundësinë stafit të angazhuar në këtë program studimit të zhvillojnë edhe kërkime inovatore në fushën e marketingut dhe neuroshkencës.</p> <p><i>Evidenca Takim me drejtuesit DMT</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Qendra e Inovacionit Marketing Turizëm</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në përgatitjen e programit të studimit kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik në zbatim edhe të direktivave dhe rekomandimeve të paraqitura në Planin Shkencor të UT 2018-2022. Në këtë aspekt program studimi ka kryer më shumë aktivitete duke përfutur edhe nga projektet, permendim ketu projektin BLUEWBC</p>



	<p>produkt i te cilit eshte edhe Qendra per Inovacion dhe Siperarrje ne Turizem. Një metodologji e plotë se si zhvillohen konkretisht aktivitetet për trajnimin e stafit, si evidentohen nevojat apo si zbatohen programet e trajnimit nuk është ende i integruar në aktivitetin e DMT megjithate kjo procedure eshte prezente per pedagoget e rinj.</p> <p><i>Evidenca: Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë</i></p> <p><i>4.5 Trajnimi i pedagogete te rinj</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Trajnimi i personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja zhvillohet në nivel institucioni, ndërsa në nivelin e DMT kryhet kryesisht nëpërmjet trainimeve tematike, periudhave të shkurtra të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në aktivitete në kuadër të projekteve KA1 Erasmus+, tavolina të rumbullakta, seminare me pjesëmarrjen e akademikëve të huaj dhe profesionistëve nga fusha dhe tematika të caktuara.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Leksione te hapura "Open Air University"</i></p> <p><i>Evidenca 2.26 Workshop dhe agjenda e workshopit</i></p> <p><i>Evidenca 4.6 Mobilitetet e stafit akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik që është përgjegjës për zbatimin dhe cilësinë e mësimdhënies merr një ndihmë të vazhdueshme nga personeli ndihmës akademik për sigurimin e një procesi cilësor të mësimdhënies por edhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi. Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen dhe azhornimin e syllabuseve, literaturës, si edhe te gjithë elementëve të tjerë të parashikuar ne procesin e mësimdhënies. IAL ka tashme një metodologji dhe procedurë e plotë se si behet azhornimi i programit te studimit por jo ne drejtim te përmirësimit te mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit te studimit Msc Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 2.27 Procedura për përmirësimin e programeve të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Stafi akademik kërkon vazhdimisht aplikimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie duke zbatuar modele specifike si për shembull metoda më interaktive në tema të caktuara por edhe duke përdorur teknologjite e informacionit. Raportimi i rezultateve të aplikimit të metodave të reja në mësimdhënie kryhen nga vetë pedagogët dhe përfshihet në vetvlerësimin e përgjithshëm të performancës së punës së tyre mësimore dhe kërkimore. Megjithatë një procedurë specifike dhe periodike të një analize mbi efektet dhe pritshmëritë nuk u vu re.</p> <p><i>Evidenca 3.8 Manuali i Vlerësimit te Performances Te Personelit Akademik te UT</i></p> <p><i>Evidenca 6.5 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 6.5.1 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2020-2021</i></p> <p><i>Evidenca 6.5.2 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020.</i></p>

	<i>Evidenca 6.6 Raporti vjetori UT-së 2019-2020</i>			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies, DMT ka përfshirë në procesin e mësimdhënies lektorë të ndryshëm vendas apo të huaj, falë bashkëpunimeve në kuadër të programeve të bashkëpunimit. Si u përmend edhe me lart DMT është përfshirë në aktivitete në kuadër të projekteve KA1 Erasmus+, tavolina të rrumbullakta, seminare me pjesëmarrjen e akademikëve të huaj dhe profesionistëve nga fusha dhe tematika të caktuara. <i>Evidenca 2.10 Leksione te hapura "Open Air University"</i> <i>Evidenca 2.26 Workshop dhe agjenda e workshopit</i> <i>Evidenca 4.6 Mobilitetet e stafit akademik</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kontrolli i dijeve dhe përvetësimit të objektivave të programit dhe kompetencave profesionale të parashikuara bëhet nepërmjet harmonizimit të disa komponentëve si për shembull testimet e vazhdueshme me shkrim dhe me goje, prezantimet e projekteve dhe detyrave të kursit, praktikave të përfshira në programin e kursit, frekuentimit dhe diskutimeve në auditor, por edhe provimeve me shkrim ose me goje, etj. Të gjitha këto forma përcaktohen në rregulloren e programit të studimeve ku përfshihen edhe mënyra e kontrollit të dijeve në për lëndët përkatëse. Studentët njoftohen mbi këtë rregullore gjatë javës së (parë të fillimit të studimeve) orientimit, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Rregullorja dhe afatet e përcaktuara në kalendarin akademik bëhen publike dhe mund të konsultohen online. Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbylles i programit të studimit vihet në dispozicion të studentëve edhe Udhëzuesi përkatës i përgatitur nga institucioni <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mesimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lendeve</i> <i>Evidenca 2.81 Formatit i diplomës MSHMR</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në	Në fillim të lëndës në çdo semester, titullari i lëndës i njeh studentët me silabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar emërimi dhe kreditet e lëndës, pedagogu i lëndës, vit/ semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin e studentit, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë tij, literatura e detyruar, si edhe mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.

syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	<i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mesimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lendeve</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Në DMT bëhet një vlerësim i vazhdueshëm i njohurive në të gjitha lëndët, duke analizuar performancën e studentit në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe në funksion të arritjes së objektivave të programit. Nga vlerësimi i syllabuseve vihet re se kontrolli i vazhdueshëm i dijeve behet nepermjet: projekteve, provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit etj. Në syllabus janë të paraqitura edhe pesha e secilit në vlerësimin final. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mesimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lendeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje (0-100%) e notës përfundimtare. Niveli i të nxëniet vlerësohet përmes detyrave me shkrim dhe /ose me gojë duke përfshirë angazhimin në diskutime, për ese të përgatitura gjatë seancave mësimore. Keshtu në këtë program studimi, aktivizimi gjatë seminareve vlerësohet me 10% të vlerësimit total, detyrat e kursit me 20% të vlerësimit, provimi i ndërmjetëm 35% të vlerësimit si dhe ai përfundimtar 35% e vlerësimit. GVJ mendon që shpërndarja e ngarkesës dhe vlerësimit gjatë gjithë vitit e mban studentin të angazhuar në mënyrë me efikasë. Provimin final realizohet me shkrim sipas rregulloreve, UT, e programit të studimit etj. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 2.1 Plani mesimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.6 Programet e lendeve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Aktualisht nuk përdoren sisteme elektronike në vlerësimin e njohurive të lëndëve, ato u përdoren kryesisht gjatë pandemisë. Por përdoret sistemi elektronik për kontrollin e provimeve. Praktika e përdorimit të Clean Score eliminon abuzimet dhe rrit transparencën. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i>

	<p><i>Evidenca 1.18 Procedure e zhvillimit te provimeve FEUT</i> <i>Evidenca 1.18.1 Rregullore e provimeve FEUT e zhvillimit te provimeve online</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për vlerësimin e provimeve nuk angazhohen anëtarë të tjerë përveç titullarit të lëndës, me përjashtim të rastit kur lenda ka edhe një asistent, pra vetëm në rastin kur lenda zhvillohet nga më shumë se një pedagog, atëherë pedagogët që e kanë zhvilluar lëndën përfshihen edhe në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Tezat e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës, nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit dhe azhurnohen rregullisht duke patur si qëllim që të vlerësojnë njohuritë e studentëve. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës dhe ndjek zhvillimin e provimit.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.18 Procedure e zhvillimit te provimeve FEUT</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. FEUT ka sistem të dedikuar Clean Score për të kryer sekretimin dhe ruajtjen e anonimatit të studentit. Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregulloret e UT parashikojnë vlerësim të detajuar për çdo pyetje dhe sqarime dhe argumentime për vlerësimin e marrë nga studenti për çdo detyrim të lëndës. Pedagogu në detyra kursit dhe provime të ndërmjetme ben edhe komente apo korrigjime në lidhje me pasaktesitë në përgjigjet e dhena.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT, neni 48, neni 51</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Ne rregulloren e UT janë të paraqitura rregullat e zhvillimit të provimit, studentit paraqitet në provim me mjet identifikimi dhe ndalohej hyrja në provim e personave të jashtëm me përjashtim të përgjegjës të departamentit dhe personave të tjere të autorizuar nga dekani ose rektori.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT, neni 48, neni 50, 51</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UT dhe asaj të DMT. Pedagogu vlerëson me pikë secilin komponent të tezës. Rezultatet e vlerësimeve të provimeve bëhen në përfundim të provimit për provimet me gojë brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të tyre për ato me shkrim. Pas korrigjimit provimet dorëzohen brenda 5 ditëve në sekretarinë mësimore së bashku me procesverbalet përkatëse. Notat i jepen studentit nga sekretaria mësimore ose nëpërmjet aksesit online. Vlerësimi për</p>

	komponentët e tjerë i dorëzohet studentit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.18 Procedure e zhvillimit të provimeve FEUT</i>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë që të ankohet për rregullat e zhvillimit të provimit brenda 24-orëve nga data e provimit dhe ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit, i cili nëse verifikon shkelje të korrigjueshme ndërmerr hapat e nevojshëm së bashku me komisionin e provimit. Në rast se shkeljet nuk janë të korrigjueshme atëherë vendimi i përcillet dekanit që nëse e shikon me vend merr vendim për anulimin e provimit dhe ri-zhfillimin e tij. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT (neni 50-51).</i> <i>Evidenca 1.18 Procedure e zhvillimit të provimeve FEUT</i>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Në rast se studenti nuk është i bindur për vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut, atëherë ankohet brenda 48 orësh me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e problemit e përcjell tek dekani. Dekanin ngre brenda 48 oreve nga marrja në dijeni për ankesën ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT (neni 50-51)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Master Shkencor në Marketing synon që të pajisë studentin me njohuritë e nevojshme si në profilin akademik ashtu edhe profesional. Programi ofron njohuri të thelluara në fushën e marketingut, duke harmonizuar aspektin teorik me metodologji e lëndë aplikative plotësojnë orientimin e moduleve të programit në fushën e ekspertizës së programit. Po kështu vlen për tu përmendur ndergjegjësimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi për të

	<p>orientuar kerkimin e tyre shkencor ne funksion te syllabuseve ne te cilet ata jane titullare per nje periudhe te gjate kohore.</p> <p><i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizem (DMT)</i></p> <p><i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i programit Master i Shkencave në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Evidenca 2.6.1 Programet e lëndëve (syllabuset) anglisht.</i></p> <p><i>Evidenca 2.7 CV-të e personelit akademik efektiv shqip dhe anglisht (2).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nepermjet lendeve te ofruara synohet zhvillimi i aftesive te vecanta ne fushen e komunikimit dhe por edhe te teknologjise se informacionit. Lende si E-marketing, Komunikimi i integruar ne marketing evidentojne nderthurje te koncepteve te marketingut me ato te komunikimit e teknologjise. Ne permbajtje te moduleve te lartpermendura studentet njihen me llojet e ndryshme te komunikimit ne medime te ndryshme te ofruara nga revolucioni teknologjik. Po keshtu lende si Metoda te Kerkimit mund te sherbejne per kerkim te aplikuar ne te gjitha detyrat e kursit ne lende te ndryshme. Menaxhimi i markes eshte nje tjetere lende qe nderthur aftesi te vecanta ne marketing, komunikim por edhe teknologji.</p> <p><i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizem (DMT)</i></p> <p><i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i programit Master i Shkencave në Marketing</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Si rregull, në përfundimit të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu eseja apo detyra e kursit që zhvillohen janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda</p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të lëndës pedagogu rikthen në fokus për studentët çështjet apo konceptet më të rëndësishme të trajtuara si dhe jep orientimet e nevojshme për përgatitjen për provim. Kjo është një praktikë që zbatohet nga programi në javën e 15 të semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit</p> <p><i>Takimi me stafin akademik te angazhuar ne programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor me lektorë apo ekspertë të ftuar me qëllim që të informoje kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Si u përmend dhe me sipër institucioni përdor kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, por</p>

<p>teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>gjithashtu konfirmuar edhe nga intervista me stafin organizohen edhe trajnime specifike (4.6 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022)). Kualifikimi I vazhdueshëm në fushën profesionale dhe atë të mësimdhënies, sikurse edhe kërkimi shkencor janë pjesë e Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Ekonomisë si edhe të DMT.</p> <p><i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizem (DMT)</i> <i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i programit Master i Shkencave në Marketing</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi harmonizon njohuritë teorike me aspektin praktike, përmes projekteve tematike apo detyrave të kursit ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila nën mbikqyret nga një pedagog i departamentit ndihmon në rritjen e aftësive profesionale dhe mundësi më të mira për integrimin në tregun e punës.</p> <p><i>1.5 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Marketing,</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Përmes detyrave të kursit simulimit të situatave reale apo edhe diskutimet me ekspertë të jashtëm, stafi akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore. Dy elemente pozitive janë përmendur edhe me sipër, Qendra për Inovacion dhe Siper marrje në Turizem dhe studente që punojnë një pooling i rendesishëm për të ushqyer diskutimet dhe evidentimin e problematikave në fushën që mbulon programin e studimit.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët</i> <i>Evidenca 2.25 Qendra e Inovacionit Marketing Turizem</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Për të nxitur një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve novative, stafi akademik perpiqet të organizojë dhe mbështesë studentët në zbatimin e aktiviteteve specifike duke përdorur qendrën e Inovacionit por edhe duke nxitur studentet të marrin pjesë në konferenca shkencore. Gjithashtu sistemi i Alumni bën të mundur që ish studente të programit të studimit të ftoheshin për të ndarë eksperiencat e tyre nga sektori. Qendra e karrierës fiton gjithashtu përfaqësues të bizneseve që në bashkëpunim me personelin akademik zhvillojnë tavolina të rrumbullaketa rreth ideve të biznesit.</p> <p><i>Evidenca 2.25 Qendra e Inovacionit Marketing Turizem</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët</i> <i>Evidenca 2.10 Leksione të hapura Open Air University</i> <i>Evidenca 5.12 Tavolina diskutimi</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e</p>	<p>Programi synon vendosjen e kërkimit shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, por edhe transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët, nëpërmjet përfshirjes së tyre në projekte. Megjithatë IAL ka paraqitur</p>

shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p><i>ne Evidencen 5.8 perfshirjen e studenteve ne projekte ne ate dokument paraqitet aktivitetit i kryer ne kuader te nje pakete pune te projektit por jo perfshirje e studenteve. Ne evidencen 2.14 paraqitet lista e mobiliteteve te FEUT, mire do te ishte qe te kishte nje detajim edhe te studenteve te programit te studimit Master Shkencor ne Marketing. Gjithashtu GVJ rekomandon qe te kete me shume bashkepunime midis pedagoqeve dhe studenteve ne kerkimet shkencore ne te ardhmen pasi kjo do ti ndihmoje studentet te aftesohen me tej per karrieren e tyre profesionale.</i></p> <p><i>Evidenca 5.8 Perfshirja e studenteve ne projekte kerkimore Blue WBC</i> <i>Evidenca 2.14 Lista e studenteve qe kane kryer mobilitete 2019-2022</i></p>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	<p>Ndërkombëtarizimi është pjesë integrale e UT por edhe DMT. Programet e mobiliteteve zhvillohen me pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve si per shembull +KA107 apo programe mobiliteti për studentët. Gjate vitit 2021-2022, 6 anetare te DMT kane zhvilluar mobilitete ne kuader te +KA107.</p> <p>Departamenti i Marketing Turizem ka nisur bashkepunimin per krijimin e nje diplome te perbashket Joint Degree in Tourism me Eberswalde University ne Gjermani.</p> <p><i>Evidenca 6.5 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca 6.5.1 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2020-2021</i> <i>Evidenca 6.5.2 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit përfundon me Mbrojtjen e Temës së Diplomës një provim publik përpara një komisioni, i cili përbëhet nga dy pedagogë dhe ngrihet për këtë qëllim. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. Teza është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij</p> <p><i>Evidenca 5.1 Rregullore e diplomimit të studentëve neni 4,5,6</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing.neni 22</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të</p>	<p>Studenti udhëhiqet gjatë periudhës së përgatitjes së tezës nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit. Për përgatitjen e tezës studentit i ofrohet edhe një ndihmë e specializuar nëpërmjet një udhëzuesi, i cili ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat dhe hapat që duhen ndjekur nga studentët për zhvillimin e tezës. Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera me pedagogun udhëheqës dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 50

<p>provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera LMS, që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës. <i>Evidenca 2.3 Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës Master i Shkencave në Marketing.</i> <i>Evidenca 2.3.1 Format mikroteze Master i shkencave.</i> <i>Evidenca 2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezave dhe praktikave MSHMR.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i DMT i profilizuar në fushën përkatëse. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët në bazë të temave që paraqesin ata ose pedagogët e programit. Mentorimi i studentit bëhet nga udhëheqësi i tezës i miratur nga departamenti në bazë të dispozitave në fuqi. Kërkesa për të propozuar temat dhe mentorin bëhet pranë kordinatorit të programit i cili harmonizon kërkesat e studentëve me mundësitë reale pa cënuar cilësinë e punimeve të diplomave dhe duke evituar përsëritjet. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing Takimi me stafin dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në përgatitjen e temës së diplomës studentët ndihmohen nga stafi i programit për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, hedhjen e të dhënave grafike apo statistikore, përpunimin e pyetësorëve apo anketave duke përdorur të gjithë infrastrukturën e bibliotekave, sallave të kompjuterave por edhe duke shfrytëzuar bazën kërkimore apo arshivore të institucioneve të tjera me të cilat programi ka marrëveshje bashkëpunimi. Aplikimi i metodave të kerkimit të aplikuar në marketing përdoret me mbështetjen e sallave laboratorike të cilat janë të pajisura me softere si Eviews, Stata, Spss Keto të fundit përdoren për analizën statistikore të kerkimeve empirike që zhvillohen nga studentet. <i>Takimi me stafin dhe studentet</i> <i>Vizita në IAL, sallat e kompjuterave</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temave të diplomës e mentoron studentin gjatë gjithë periudhës së përgatitjes së saj duke e orientuar studentin për përgatitjen e temës në zbatim të udhëzuesve të miratuar dhe në përmbushje të standarteve akademike. Punimi i diplomës duhet të respektojë kërkesat e formatit dhe rregullat e etikës akademike. Në përfundim, udhëheqësi i temës nënshkruan temën e diplomës që do të mbrohet përpara komisionit të krijuar nga DMT. <i>Evidenca 2.3 Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës Master i Shkencave në Marketing.</i> <i>Evidenca 2.3.1 Format mikroteze Master i shkencave.</i></p>

	<i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos komisioni i ngritur për këtë qëllim. Sezonet e rregullta të mbrojtjes së diplomës janë ato të verës, vjeshtës dhe dimrit ndërsa sezone specifike mund të përcaktohen me urdhër të drejtorit të Dekanit. Anëtarët e komisionit bien dakord për notën dhe në rast se kjo nuk arrihet vendoset mesatarja e notave të propozuara nga të dy anëtarët. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i>			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave në “Marketing” dhe suplementin e saj, sipas formatit të miratur nga MASR dhe i firmosur nga Dekani i FE dhe Rektori i UT. <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i> <i>Evidenca 2.8 Suplementi i Diplomës në shqip dhe anglisht</i> <i>Evidenca 2.8.1 Formati i diplomës MSHMR</i> <i>Evidenca 2.9 Evidence Microsoft Teams kontaktet pedagog student per udheheqjen e mikrotezes</i>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të programit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>Evidenca 2.8 Suplementi i Diplomës në shqip dhe anglisht</i> <i>Evidenca 2.8.1 Formati i diplomës MSHMR</i> <i>Evidenca 2.9 Evidence Microsoft Teams kontaktet pedagog student per udheheqjen e mikrotezes</i>			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Pas përfundimit të studimeve, kopje e dokumentacionit të studentit të regjistruar arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje me detyrimet institucionale, informacioni i paraqitet palëve të interesuara në përputhje me normativat ligjore për ruajtjen e të dhenave personale. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse apo nevojave të vetë institucionit <i>Takim me Degën e Burimeve Njerëzore</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>UT në strukturën e saj ka edhe Drejtorinë e Shërbimeve të brendshme, në varësi të së cilës janë edhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arkivës (<i>Evidenca 1.2 Rregullore UT përditesuar 2016, Shtojca nr.2</i>). Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë UT (<i>Evidenca 1.2 Rregullore UT përditesuar 2016, neni 31; Shtojca nr.2; faqja 35-36</i>). FE ka në strukturën e tij ka Degën e e Njerëzore Burimeve dhe Degën e Protokoll-Arkivës në nivel fakulteti (<i>Evidenca 1.8 Organigrama FEUT</i>).</p> <p>Nga intervistimi i personelit të Degës së Burimeve njerëzore por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë (<i>Evidenca 4.25 Njoftim për përditësim të dosjeve personale</i>).</p> <p>Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcaktonte Departamenti përkatës, në vijim pritëshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim. Zyra e personelit ishte pjesë e të gjitha hallkave të procesit duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme (një PAK dhe një PAE) nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UT në përputhje me <i>nenin 67 dhe 68</i> të statutit ka të përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Rregulloren e programit dhe atë të Fakultetit (<i>Evidenca 1.1 Statuti Ri I_UT me shkrese., Neni 67, 68</i>). Në bazë të dokumentacionit si edhe në vizitën që GVJ pati në institucion evidentohet e gjithë rruga dhe procedurat që ndiqen për punësimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik. Departamenti bën planifikimin për staf akademik bazuar në nevojën dhe mbingarkesën e stafit aktual, dhe kjo kërkesë kalohet për miratim tek Rektori i UT, pasi është miratuar nga Dekani i FEUT. Pasi kërkesa miratohet, nga Fakulteti ajo publikohet në faqen e internetit të institucionit. Cdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision ad-hoc, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, fakultetit dhe departamentit të gjithë me gradën “Profesor” (<i>Evidenca 4.3. Procedura e rekrutimit të personelit akademik</i>). Gjithashtu duke ju referuar dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion, UT ka hartuar edhe procedurat e punësimit pranë UT për stafin akademik PAE, PAK, stafin ndihmës akademik etj (<i>Evidenca 4.27 Manuali</i></p>

	<i>Punesimit V. Nr.2 Date 24.01.2022).</i>			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat e rekrutimit të personelit. Departamenti përcakton kriteret specifike duke respektuar kriteret e përgjithshme të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UT (<i>Evidenca 1.1 Statuti Ri I_UT me shkresë, neni 14; neni 67-69</i>). Shpallja e pozicioneve bëhet publike në faqen zyrtare ëeb të FEUT si dhe në Buletinin e njoftimeve të APP. (<i>Evidenca 4.4 Njoftim për vend pune Marketing_Buletini nr. 179 dt. 13.12.2021.</i>) Aplikimet kalojnë një sistem pikëzimi dhe e gjithë procedura e rekrutimit është përcaktuar nëpërmjet një procedure të miratuar. (<i>Evidenca 4.3. Procedura e rekrutimit të personelit akademik</i>). Nga përzgjedhja e dosjeve të stafit të programit gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore gjendet dokumentacioni si, kontrata e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata e titujve të tjerë akademik, CV etj.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	GVJ, nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion por edhe bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konkludon se Institucioni ka por gjithashtu edhe ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi për personelin akademik PAE dhe PAK të nevojshëm për ecurinë e programit të studimit. <i>Evidenca 1.1 Statuti Ri I_UT me shkresë, neni 67.</i> <i>Evidenca 4.3. Procedura e rekrutimit të personelit akademik</i> <i>Evidenca 4.27 Manuali punesimit v. Nr.2 date 24.01.2022.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni sikurse edhe nga vizita që GVJ pati në mjediset Infrastruktura e FE krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale, kjo edhe si rezultat i ristrukturimit të godinës ekzistuese në vitin 2021. FE ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike dhe procesin mësimor sikurse në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore

	<i>(Evidenca 3.10 Kapacitetet infrastrukturore; Evidenca 2.25 Qendra Inovacionit Marketing Turizëm).</i>			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni përdor kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, por gjithashtu konfirmuar edhe nga intervista me stafin organizohen edhe trajnime specifike <i>(4.6 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022))</i> . Një nismë që ka marrë Fakulteti në kuadër të rekrutimit të stafit të ri akademik është edhe trajnimi i stafit të ri në fushën e mësimdhënies dhe pedagogjisë <i>(Evidenca 4.5 Trajnimi i pedagogëve të rinj)</i> . GVB e evidentoi këtë sin ë dokumentacion ashtu edhe në takimet që pati në institucion me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjës të departamentit sikurse edhe me stafin akademik të këtij programi studimi. Kualifikimi I vazhdueshëm në fushën profesionale dhe atë të mësimdhënies, sikurse edhe kërkimi shkencor janë pjesë e Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Ekonomisë si edhe të Departamentit <i>(Evidenca Strategjia e Zhvillimit UT (2018-2023); Evidenca 1.6 Plani kerkimit shkencor UT (2018-2022), Evidenca Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizem (DMT))</i> .			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Gjatë periudhës së COVID19, sikurse edhe në IAL e tjera në vend, u pa domosdoshmëri, implementimi I metodave të reja të mësimdhënies në distancë. Edhe Universiteti I Tiranës ndërmoi masat për trajnimin e stafit akademik për përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies në distancë sikurse edhe në organizimin e provimeve në distancë. <i>Evidenca 3.2 Udhezues i UT per përdorimin e sistemit të mësimin në distance.</i> <i>Evidenca 3.4 Manual perdorimi Udhezues Microsoft Teams</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore Provimet në distance.</i>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Institucioni ka angazhuar staf akademik PAE dhe PAK për të plotësuar kërkesat e programit, të cilët kanë përgatitjen profesionale në fusha të ndryshme dhe të angazhuar në mënydhënie të lëndëve që përputhen me fushat e tyre të kërkimit shkencor. <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa vjetore e personelit akademik 2021-2022, 2020-2021,2019-2020</i> <i>Evidenca 2.7 CV-të e personelit akademik efektiv shqip dhe anglisht (2)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për	Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastrukturën e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Ekonomisë, GVJ konstaton se insitucioni disponon salla leksionesh

<p>zhvillimin e veprimtarisë mesimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mesimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>dhe auditorë për seminare. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektorë. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerezore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambjentet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. <i>Evidenca 3.10 Kapacitetet infrastrukturore</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mesimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mesimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mesimdhënies-mesimnxënies.</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambjentet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambjente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve dhe seminareve, janë të pajisur me kompjutera e projektorë (<i>Evidenca 02 Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, Tabela 16, 21</i>). Godina ku zhvillohet mesimi për këtë program studimi, plotëson të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", sipas të cilit kërkohen 2.5 m² / student. Mjediset ku zhvillohet procesi mesimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në këtë program studimi nuk zhvillohen laboratorët, për shkak të tipologjisë së lëndëve që zhvillohen, por gjithsesi, Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ka vënë në dispozicion edhe Qendrën e Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Marketing Turizëm. Gjithashtu në rast nevojë mund të përdoren edhe ambjentet e laboratorëve që gjenden në Fakultet, të cilët janë të pajisur me një sërë software.</p> <p><i>Evidenca 3.10 Kapacitetet infrastrukturore</i> <i>Evidenca 2.25 Qendra Inovacionit Marketing Turizëm</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ka vënë në dispozicion edhe Qendrën e Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Marketing Turizëm e cila është e pajisur me kompjutera ku janë instaluar softëare SPSS për analizën dhe përpunimin e të dhënave. Gjithashtu në këtë qendër është aktual edhe programi Eye Tracking e cila mund të përdoret për studime të shumta marketing.</p> <p><i>Evidenca 2.25 Qendra Inovacionit Marketing Turizëm</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin. Institucioni dhe Fakulteti kanë marrëveshje të shumta bashkëpunimi me kompani dhe institucione të tjera, në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca 2.18 Marrëveshje Institucionale UT.</i> <i>Evidenca 2.18.1 Lista e marrëveshjeve FEUT për realizimin e Praktikave Profesionale.</i></p>

profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p><i>Evidenca 2.18.3 Memorandum bashkepunimi mes FEUT dhe Balfin Group</i></p> <p><i>Evidenca 2.18.4 Lista e Institucioneve dhe kompanive në të cilat studentët e Master i Shkencave në Marketing kanë zhvilluar praktikat 2021-2022.</i></p> <p><i>Evidenca 02 Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, Tabela 5.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion u konstatua se në dispozicion të studentëve ekziston biblioteka, në godinën ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi. Në mjediset e këtyre bibliotekave studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studjuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. GVJ evidentoi se biblioteka përdoret nga studentët e këtij programi studimi, si rezultat I përputhshmërisë së orarit të mësimit me orarin zyrtar të bibliotekës. Pavarësisht se orari I zhvillimit të mësimit në këtë program studimi është mbasdate, Biblioteka gjithashtu zhvillon aktivitetin e saj duke organizuar punën në 2 turne nga 08.30 deri në 19.30. <i>Evidenca 4.14 Informacion nga Biblioteka e FEUT</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ishte përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike në shqip dhe anglisht. Studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës e pajisur me kompjutera dhe akses në internet. Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë. Cdo vit akademik, pedagogët mund të depozitojnë kërkesat e tyre për literaturën e nevojshme dhe mbështetëse të re për tu patur në bibliotekë. <i>Evidenca 4.14.1 Lista e plotë e librave të bëra hyrje në bibliotekë në periudhën 2019-2021.</i> <i>Evidenca 4.16 Lista e librave në Bibliotekën e FEUT në funksion të programit Msc në Marketing.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka krijuar akses të vecantë në biblioteka online të tilla si: JSTORE, U-Library (<i>Evidenca 4.8 UT_manual perdorimi Jstor</i>) COBISS + u krijon mundësinë përdoruesve të këtyre bibliotekave onlive qasjen dhe përdorimin e tyre (<i>Evidenca 4.9 Formular COBISS</i>). Përdoruesit pajisen me të dhënat e bibliotekave online si edhe me kredencialet (pasëordin) për përdorimin e tyre pa pagesë (<i>Evidence 4.14 Informacion nga Biblioteka e FEUT</i>).

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion por edhe gjatë vizitës që GVJ pati në Institucion, evidentoi se Biblioteka është e pajisur me 11 kompjutera që mund të përdoren për studim dhe punime, të gjitha të pajisura me akses internet. Gjithashtu Biblioteka është e pajisur me EË-fi që mund të përdoret për akses pa limit edhe në bibliotekën online.</p> <p><i>Evidenca 4.15 Biblioteka FEUT_mjediset</i> <i>Evidenca 4.16 Lista e librave në Bibliotekën e FEUT në funksion të programit Msc në Marketing.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Cdo vit kalendarik, biblioteka në bashkëpunim me njësitë kryesore sipas procedurave të përcaktuara, përcakton kërkesat për blerje librash, për shtim titujsh apo edhe kopjesh.</p> <p><i>Evidenca 4.14.1 Lista e plotë e librave të bëra hyrje në bibliotekë në periudhën 2019-2021.</i> <i>Evidenca 4.18 Buxhet afatmesem, Vendim i Bordit të Administrimit UT buxhet afatmesem 2020-2022</i> <i>Evidenca 4.16 Lista e librave në Bibliotekën e FEUT në funksion të programit Msc në Marketing</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>GVJ evidentoi se biblioteka përdoret nga studentët e këtij programi studimi, si rezultat i përputhshmërisë së orarit të mësimin me orarin zyrtar të bibliotekës. Pavarësisht se orari i zhvillimit të mësimin në këtë program studimi është mbasdate, Biblioteka gjithashtu zhvillon aktivitetin e saj duke organizuar punën në 2 turne nga 08.30 deri në 19.30 për të qenë në funksion të nevojave të studentëve dhe stafit akademik që zhvillojnë mësimin mbasdate.</p> <p><i>Evidenca 4.14 Informacion nga Biblioteka e FEUT</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sërë procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin. Sekretaria mësimore disponon një sistem kompjuterik menaxhimi dhe administrimi të informacionit të studentit nga krijimi i kartelës dhe regjistrimi i parë deri në diplomim të tij (sekretaria online). Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajiset me numër matrikullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e Universitetit në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës</p>

	<p>në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.</p> <p><i>Evidenca 4.10 Rregullore per funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës.</i></p> <p><i>Evidenca 4.11 Manual përdorimi E-Student Pedagogët.</i></p> <p><i>Evidenca 4.12 Portali E-student logari hyrëse si evidencë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar takimit të zhvilluar të GVJ me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto të dhëna ruhen kryesisht në formë manuale por edhe elektronike në disa njësi të Universitetit si departamenti, fakulteti, universiteti, zyra e burimeve njerëzore etj.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik dhe ndihmës akademik, komunikojnë me studentët nëpërmjet email-ve sikurse edhe nëpërmjet platformës Teams.</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022 është krijuar mundësi e përdorimit të një sistemi të brendshëm informacioni për aksesim dhe komunikim të brendshëm mes stafit akademik dhe ndihmës akademik por gjithashtu edhe me studentët nëpërmjet implementimit të platformës e-student/pedagogët.</p> <p><i>Evidenca 4.24 Ndërveprimi në sistemin Microsoft Teams.</i></p> <p><i>Evidenca 4.10 Rregullore per funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës.</i></p> <p><i>Evidenca 4.11 Manual përdorimi E-Student Pedagogët.</i></p> <p><i>Evidenca 4.12 Portali E-student logari hyrëse si evidencë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës që GVJ pati në Institucion, në takimin me stafin akademik të programit u evidentua se që nga periudha e pandemisë Covid-19 e në vazhdim, stafi akademik dhe studentët komunikojnë ndër të tjera edhe nëpërmjet platformës Teams. Në këtë platform, pedagogët mund të informojnë studentët në lidhje me gjithcka për lëndët përkatëse si edhe vendosin leksionet, materialet bazë apo ndihmëse, raste studimi etj.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në Departamentin e Marketingut dhe Turizmit, bëhet nga përgjegjësi i departamentit. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimin, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në fakultet. Gjatë takimit që GVJ pati në institucion, u evidentua se përveçse platformave Teams dhe E-student/pedagogët, synohet drejt një sistemi menaxhimi më të konsoliduar për mbajtjen e të dhënëve, monitorimin dhe koordinimin midis të gjithë stafit akademik, ndihmës akademik e administrative brenda Fakultetit.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit,</p>	<p>Nga konstatimi i GVJ faqja eeb zyrtare e Universitetit (ëëë.unitir.edu.al) si edhe ajo e Fakultetit, ndër të tjera, përfshin</p>

personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	informacion lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme. Faqja ëeb është e ndërtuar në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Përveç kësaj fakulteti por edhe Departamenti i Marketingut dhe Turizmit është aktive edhe në rrjetet sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se Institucioni harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Buxheti financiar shqyrtohet nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve në Universitetin e Tiranës, e cila përlllogarit koston e mbulimit të një cikli të plotë studimi, për çdo student në të gjitha ciklet e studimeve në institucion. Ky raport më pas kalohet në Rektorat, më pas miratohet në Senatin Akademik dhe më pas i kalohet për miratim Bordit të Administrimit. <i>Evidenca 0.RVB MSHMR Scan</i> <i>Evidenca 4.17 Buxheti UT 2019. Vendim I Bordit të Administrimit UT.</i> <i>Evidenca 4.18 Buxhet afatmesem. Vendim I Bordit të Administrimit UT buxhet afatmesem 2020-2022.</i> <i>Evidenca 4.19 Buxheti i miratuar FEUT.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në planin financiar përfshihen (a) të ardhura: buxheti i shtetit, tarifatat e shkollimit, tarifatat e regjistrimit, të ardhura nga shërbime të ndryshme të kryera, donacione e burime të tjera etj., (b) shpenzime: për pagat, shpenzime operative, sigurimin e cilësisë, pasurimin e bibliotekës etj. Të gjitha kategoritë e këtij kriteri janë të përfshira në këtë plan. <i>Evidenca 0.RVB MSHMR Scan.</i> <i>Evidenca 4.17 Buxheti UT 2019. Vendim I Bordit të Administrimit UT.</i> <i>Evidenca 4.18 Buxhet afatmesem. Vendim I Bordit të Administrimit UT buxhet afatmesem 2020-2022.</i> <i>Evidenca 4.19 Buxheti i miratuar FEUT.</i>

tjerë, sipas natyrës specifike të tij.									
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Institucioni, nëpërmjet Sektorit të Auditit të Brendshëm i cili është nën varësinë e Bordit të Administrimit të Institucionit, kryen audit të brendshëm të përvitshëm (<i>Evidenca 4.28-Program Auditit</i>). Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike Sektori i Auditit të Brendshëm pranë UT, bën relacion mbi projekt buxhetin me qëllim që të kontrollojë mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së studimeve. <i>Evidenca 0.RVB MSHMR Scan.</i>								
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Institucioni harton raportin për tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si dhe nivelin e shpenzimeve. Raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare. <i>Evidenca 0.RVB MSHMR Scan.</i>								
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	GVJ, duke ju referuar RVB, evidenton se Institucioni dëshmon dhe garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe kjo duke ju referuar numrit gjithmone ne rritje të studentëve të regjistruar në programet e studimit të ofruara nga UT. Gjithashtu bazuar tek RVB, por edhe gjatë takimit që GVJ pati me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Institucioni dëshmon se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, kjo bazuar edhe në faktin se cdo vit ka një fond (të ardhura) prej 50% të trashëguar nga viti paraardhës. <i>Evidenca 0.RVB MSHMR Scan.</i> <i>Evidenca 4.19 Buxheti i miratuar FEUT.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Statuti i Institucionit, Rregullorja e institucionit, rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e programit të studimit janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullorja e institucionit (neni 78 - 83), rregullorja e programit të studimit (neni 11 dhe 14), specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti Ri I UT me shkresë.</i> <i>Evidenca 1.2 RREGULLORE UT perditesuar 2016.</i> <i>Evidenca 2.5.1 Plani strategjik i programit Master i Shkencave në Marketing.</i> <i>Evidenca .2.5-2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizem (DMT).</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos nga intervistat me studentët e programit gjatë vizitës në institucion, konstatoi se politikat dhe procedurat e ndjekura nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit. Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e UT si edhe në <i>Evidencën 2.12 (Kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021Cikli I II-të)</i> sikurse edhe në kuotat e propozuara (<i>Evidenca 2.13 Kuotat e propozuara per ciklin e dyte te studimeve master</i>). Procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Tiranës.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti Ri I UT me shkresë.</i> <i>Evidenca 1.2 RREGULLORE UT perditesuar 2016.</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing.</i> <i>Evidenca 2.12 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021Cikli I II-të.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UT, si edhe të programit të studimit. Nga takimi që GVJ pati në Institucion u konfirmua që institucioni përdor ndër të tjera edhe faqen zyrtare të UT si edhe faqen web të fakultetit, për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit. Gjithashtu bazuar tek RVB, sikurse edhe gjatë takimeve që GVJ pati në institucion, konstatoi se, Fakulteti, Departamenti, Sekretaria, Zyra e financës sikurse edhe të gjitha zyrat e tjera janë gjatë gjithë kohës në dispozicion të studentëve, sipas orarit të tyre të shpallur</p>

	<p>për pritjet dhe takimet, për të informuar studentët që nga fillimi i studimeve sikurse edhe gjatë ciklit të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 1.2 RREGULLORE UT perditeluar 2016.</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i> <i>Evidenca 5.4 Rregullore Procedure e transferimit te studimeve.</i> <i>Evidenca 0.RVB MSHMR Scan</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës, miraton në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse. Kriteret ndër të tjera publikohen në faqen eeb të Universitetit si edhe në atë të Fakultetit.</p> <p><i>Evidenca 2.12 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021Cikli I II-të</i> <i>Evidenca 2.13 Kuotat e propozuara per ciklin e dyte te studimeve master</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Përpara cdo fillimi viti akademit, sipas informacionit që GVJ siguroi gjatë vizitës në institucion, sikurse edhe në informacionin e pasqyruar në RVB, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë si edhe Departamenti i Marketing Turizmit, njeh palët e interesuara me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për cdo program. Departamenti së bashku me Fakultetin organizojnë dhe marrin pjesë në aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim ndër të tjera edhe informimin e palëve të interesuara për programet e studimit që ofrojnë. Kjo bëhet e mundur gjithashtu nëpërmjet broshurave si edhe informacionit në faqen Web.</p> <p><i>Evidenca 5.5.1 Broshurë për informimin e publikut mbi programin e studimit.</i> <i>Evidenca 5.5 Guida studentore, DMT</i> <i>Evidenca 0.RVB MSHMR Scan.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloren e Universitetit (Kreu 1), si edhe në Rregulloren e programit të studimit. Rregulloret u vihen në dispozicion dhe u bëhen të njohura studentëve edhe në takimet që kanë studentët me zyrën e pranimit dhe Zyrën e karrierës.</p> <p><i>Evidenca 1.2 RREGULLORE UT perditeluar 2016.</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i></p>

	<p><i>Evidenca 5.5 Guida studentore, DMT</i> <i>Evidenca 5.9 Rregullore e Zyrës së Karrierës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Rregullorja e Institucionit, rregullorja e programit të studimit si edhe rregullorja e rregjistrimeve dhe transferimeve, përcaktojnë procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të Universitetit të Tiranës në Institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hoc i Ekuivalentimit. Studentëve u vihet në dispozicion rregullorja, nëpërmjet të cilës ata njihen me kriteret e transferimeve.</p> <p><i>Evidenca 1.2 RREGULLORE UT perditeluar 2016.</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i> <i>Evidenca 5.4 Rregullore Procedure e transferimit te studimeve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore (<i>Evidenca 1.2 RREGULLORE UT perditeluar 2016, neni 45</i>) Rregulloren e programit të studimit (<i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc.Marketing</i>), si edhe në syllabuset e cdo lënde (<i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i>). Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimit, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e universitetit, rregulloren e e programit të studimit sikurse edhe në rregulloren e vecantë të diplomimit të studentëve, dhe janë të detajuara në atë të programit përkatës të studimit. Departamenti ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjësin e departamentit dhe koordinatorin e programit si edhe pedagogët udhëheqës të tyre.</p> <p><i>Evidenca 5.1 Rregullore e diplomimit të studentëve</i> <i>Evidenca 2.3 Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës Master i Shkencave në Marketing.</i> <i>Evidenca 1.8.1 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Para fillimit të cdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe me pjesmarrjen e maturantëve të shkollave të mesme. Gjithashtu Departamenti është shumë aktiv në rrjetet sociale, përgatit fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij.</p> <p><i>Evidenca 5.2. Ditet e informimit te maturantëve</i> <i>Evidenca 5.5 Guida studentore, DMT</i> <i>Evidenca 5.5.1 Broshurë për informimin e publikut mbi programin e studimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet në mënyra të ndryshme, që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë etj. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqen në faqen e internetit të Universitetit, (www.unitir.edu.al), në faqen e fakultetit (ëëë.feut.edu.al) sikurse edhe në mediat sociale.</p> <p><i>Evidenca 5.5 Guida studentore, DMT</i> <i>Evidenca 5.5.1 Broshurë për informimin e publikut mbi programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimin për cdo lëndë u bëhet i njohur programi i lëndës. Një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambjentet e institucionit. Sipas intervistave në institucion dhe RVB-së, në faqen web të Universitetit si edhe të Fakultetit, publikohen planet mësimore; edhe nga verifikimi i kryer, informacioni që ofrohet në faqen e internetit është i pranueshëm dhe kurrikula e disponueshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet zyrës së informimit, nëpërmjet departamentit si kurse edhe Zyrës së Karrierës. Gjithashtu kjo zyrë mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione publike dhe biznese.</p> <p><i>Evidenca 5.9 Rregullore e Zyrës së Karrierës</i> <i>Evidenca 2.18.4 Lista e Institucioneve dhe kompanive në të cilat studentët e Master i Shkencave në Marketing kanë zhvilluar praktikat 2021-2022</i> <i>Evidenca 2.18.3 Memorandum bashkëpunimi mes FEUT dhe Balfin Group</i> <i>Evidenca 5.11 Panairi i Karrierës.</i></p>


<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit, si kurse edhe në faqen eeb të Fakultetit dhe studentët në javën e parë të mësimit, informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e universitetit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Studentët e këtij programi e ndjekin mësimin mbasdite ora 17.00-20.00, një mundësi kjo për të ndihmuar studentët e punësuar.</p> <p><i>Evidenca 5.5 Guida studentore, DMT</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Universiteti, Fakulteti sikurse edhe Departamenti, punojnë fort me komunikimin online në rrjetet sociale për të mbajtur studentët e informuar mbi programet e studimit dhe aktivitetet në universitet. Gjithashtu, gjatë intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se cdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët si edhe në ambjentet e bibliotekës. Komunikimi ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, për jerash, mundësohet edhe nëpërmjet platformës Teams. Gjithashtu aktive për komunikimin e brendshëm me studentët është edhe platforma E-student.</p> <p><i>Evidenca 3.4 Manual perdorimi Udhezues Microsoft Teams.</i> <i>Evidenca 4.11 Manual përdorimi E-Student Pedagogët.</i> <i>Evidenca 4.12 Portali E-student logari hyrëse si evidencë.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Përmes platformës E-student, bëhet e mundur komunikimi i brendshëm me studentët sikurse edhe ndjekja e aktivitetit të tyre nga rregjistrimi e deri në diplomim.</p> <p><i>Evidenca 4.11 Manual përdorimi E-Student Pedagogët.</i> <i>Evidenca 4.12 Portali E-student logari hyrëse si evidencë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Për programin e studimit sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Ekonomisë sikurse edhe nga dokumenti shtesë i i kërkuar nga GVJ dhe i vënë në dispozicion nga Institucioni.</p> <p><i>Evidenca 0.2. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB.</i> <i>Evidenca 3. Dokumenta shtesë. Shkresë Dokumenta shtesë për vlerësimin e jashtëm Msc Marketing, Universiteti i Tiranës</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për çdo vit akademik.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Evidenca 0.2. Aneks Tabelat përmbledhëse RVB, tabela 21</i>) dhe vizitës që GVJ pati në sekretarinë mësimore, numri i studentëve për tre vitet akademike rezulton si më poshtë poshtë:</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 janë 60 studentë të regjistruar Në vitin akademik 2020-2021 janë në total 75 studentë. Në vitin akademik 2021-2022 janë në total 81 studentë.</p> <p>Gjithashtu Universiteti për çdo program studimi, harton raporte të përvitshme në lidhje me të dhëna si: rregjistrimet e studentëve, largimet, numri i transferimeve, nota mesatare në hyrje në hyrje e në dalje etj.</p> <p><i>Evidenca 6.6 Raporti vjetori UT-së 2019-2020.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre (<i>Evidenca 5.3 -Rregullore e sekretarisë mësimore</i>). GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi rregjistrat themelor ku çdo student i regjistruar, vetëm në momentin e diplomimit hidhej në këtë rregjistër dhe i vendosej numri i matrikullimit. Të dhënat për studentët e regjistruar, për të gjithë programet e studimit në Fakultetin e Ekonomisë, mbaheshin në rregjistra por pa bërë ndarjen sipas programeve të studimit. Rregjistrimi ishte sipas vitit akademik dhe jo sipas programeve të studimit me numra rendorë përkatës për të qenë më të qartë numri i të regjistruarve sipas programeve të studimit.</p> <p><i>Kështu, GVJ, sugjeron mbajtjen në mënyrë më të saktë në rregjista të studentëve sipas programeve të studimit duke filluar me numër rendor 1 deri tek i fundit për çdo program studimi. Gjithashtu, bazuar në faktin që të dhënat në rregjistrin themeltar hidheshin vetëm në momentin kur studentit diplomohet dhe tërhiqte diplomën, GVJ sygjeron se pavarësisht volumit të madh të punës që sekretaria mësimore mund të ketë, duhet të organizohet më mirë në hedhjen e të dhënave të studentëve në rregjistrin themeltar, me numrin e tyre të matrikullimit.</i></p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar. Dosja e studentëve ishte e pajisur me dokumentat si vijon: kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, diploma e shkollës së mesme, diploma e studimeve të ciklit të parë dhe lista e notave.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 5.3 -Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>

verifikueshme nga personat e autorizuar.									
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Në fund të cdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Për diplomimet në vitet e mëparshme disponohen të dhëna të plota si për notat mesatare në hyrje dhe dalje si dhe punësimin e tyre. <i>Evidenca 6.6 Raporti vjetori UT-së 2019-2020.</i> <i>Evidenca 6.5 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca 0.2. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 21</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Shkalla e përmbushjes së standardit</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nëpërmjet Statutit të Universitetit të Tiranës (<i>neni 129</i>), institucioni parashikon angazhimin dhe vendimmarrjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe kulturore, ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. <i>Evidenca 1.1- Statuti i UT</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion, GVJ konfirmoi se studentët ishin të përfshirë në procesin e vlerësimit të programeve të studimeve (pjesë e GVB). (<i>Evidenca 0.3. Dosja e Aplikimit per Akreditimin e Programit te studimit</i>). Nga biseda me grupin e studentëve u kuptua qe ata këshillohen me stafin akademik dhe shefin e departamentit si edhe përdorin zyrat mbështetëse për këtë qëllim. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin Studentor (<i>neni 133 i Statutit të UT</i>). Studentët kishin përfaqësuesin e tyre në zyrën e NJBSC (<i>neni 41 i Statutit të UT</i>), në Senatit Akademik (<i>neni 30 i Statutit të UT</i>), sikurse edhe në Këshillin e Etikës (<i>neni 43 i Statutit të UT</i>).
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave	GVJ konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve sikurse edhe orët në auditor dhe jashtë auditorit. Statuti i Universitetit të Tiranës dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. Institucioni gjithashtu ka hartuar procedurat që duhet të ndiqen për përmirësimin e programeve të



<p>joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>studimit. Programi i studimit ka 120 kredite të ndara përkatësisht në 64 kredite vitin e parë dhe 56 kredite në vitin e dytë. Konkretisht ky program studimi përmban në të dy vitet akademike, 1350 orë në auditor dhe 1650 orë jashtë auditorit. Gjithashtu, për shkak të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mobilitetit të studentëve, Institucioni ka miratuar edhe rregulloren dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe lëndëve përkatëse që studentët organizojnë në Universitetet pritëse.</p> <p><i>Evidenca 1.1- Statuti i UT</i> <i>Evidenca 2.27 Procedura për përmirësimin e programeve të studimit.</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e Programit të studimit Msc. Marketing</i> <i>Evidenca 2.15.1 Njohja e lëndëve nga programet e mobilitetit Studente A. Kristo.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendim marrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit (<i>Evidenca 1.1- Statuti i UT, neni 129</i>).</p> <p>Si një mënyrë e drejtëpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetëtori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri (<i>Evidenca 6.2.4 Anketimi NJSBC - Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve të studentëve</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Rregullorja e Institucionit (<i>neni 50 dhe 51</i>), dhe rregullorja e programit të studimit Msc në Marketing (<i>neni 20</i>), mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqen nga institucioni në këtë rast.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit sikurse edhe takimit që pati me stafin akademik, evidentoi se mbështetja e Institucionit në fushën e kërkimit shkencor është prezent ndër të tjera edhe në mbështetjen financiare (<i>Evidenca 1.13 Programi grantit per prezantimin e punimit ne konferenca</i>).</p> <p><i>Megjithate GVJ bazuar edhe në këtë dokumentacion të vënë në dispozicion, evidenton se mbështetja financiare për stafin akademik me kohë të plotë, që mund të përfitojnë nga ky grant, është vetëm 1 herë në 2 vjet. Pra, stafi akademik, nuk ka mbështetje financiare në cdo kohë</i></p>

	<p><i>dhe të pakushtëzuar nga institucioni për pjesëmarrjen në konferenca. Kështu, GVJ, sygjeron mbështetjen financiare më të madhe për stafin akademik me kohë të plotë në konferenca apo aktivitete ndërkombëtare.</i></p> <p>Gjithashtu stafi akademik është pjesë e një sërë projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare. (Evidenca 2.20 Projektet FEUT Përfshirja e stafit të Dep. Marketing Turizem ne nivel ndekombetar e kombetar.) Evidenca 2.22 Puna kerkimore-shkencore 2018-2022.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit ekzistojnë në nivel institucioni, në nivel fakulteti apo edhe në nivel departamenti me institucione huaja të arsimit të lartë kryesisht për mobilitete të stafit dhe studentëve, projekte kërkimore sikurse edhe për ofrimin e diplomave përbashkëta.</p> <p><i>Evidenca 2.25 Qendra Inovacionit Marketing Turizëm.</i> <i>Evidenca 2.16 Mobilitete të personelit akademik të huaj pedagogu pritës.</i> <i>Evidenca 4.6 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022).</i> <i>Evidenca 2.20 Projektet FEUT Përfshirja e stafit të Dep. Marketing Turizem ne nivel ndekombetar e kombetar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Përvec konferencës që Fakulteti i Ekonomisë organizon, në të cilën marrin pjesë stafi akademik me punimet e tyre, organizohet gjithashtu edhe konferenca studentore ku studentët prezantojnë punimet e tyre shkencore. Në përfundim të kësaj konference, vlerësohen edhe 3 artikujt më të mirë të konferencës studentore.</p> <p><i>Evidenca 2.19 Lista e konferencave të realizuara në periudhën 2018-2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik si edhe me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, u theksua se në përgjithësi stafi ka mbështetje financiare për publikimet në revista si edhe për pjesëmarrjen në konferenca shkencore por pa u përmendur asgje konkrete. Gjithashtu, GVJ duke shqyrtuar edhe dokumentacionin e venë në dispozicion, nuk eidentoi ndonjë praktikë apo shembull konkret të financimit apo mbështetjes financiare të stafit akademik nga ana e Institucionit për publikime në revista shkencore ndërkombëtare.</p> <p>GVJ sygjeron mbështetjen financiare nga ana e Institucionit për publikimet në revistat shkencore të cilat në përgjithësi kanë tarifa publikimi të konsiderueshme.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik si edhe me studentët e këtij programi të studimit, si edhe bazuar në syllabuset e lëndëve, eidentoi se në pjesën më të madhe të lëndëve, studentët duhet të pregatisin detyra kursi apo projekte individuale apo edhe në grup. Kjo i ndihmon ata për të zhvilluar të menduarin në mënyrë analitike ashtu sikurse shpesh herë kërkon zhvillimin e aftësive inovative.</p> <p>Gjithashtu edhe konference studentore e zhvilluar në nivel Fakulteti, nxit dhe motivon studentët për tu fokusuar më tepër kërkimin shkencor.</p> <p><i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset).</i> <i>Evidenca 2.19 Lista e konferencave të realizuara në periudhën 2018-2022.</i></p>

Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Gjatë takimit që GVJ pati në institucion me stafin akademik, në lidhje me procedurat e realizimit të diplomës, u evidentua se stafi akademik është vazhdimisht i gatshëm duke ofruar ekspertizën dhe ndihmën e tyre për realizimin e diplomës që nga përzgjedhja e temës e deri në përfundimin e diplomës. <i>Evidenca 2.3 Udhëzues për përgatitjen e mikrotezës Master i Shkencave në Marketing.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe institucione në vend sikurse edhe institucione jashtë vendit, në kuadër të praktikave profesionale si edhe mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik. <i>Evidenca 2.18 Marrëveshje Institucionale UT.</i> <i>Evidenca 5.10 Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të mobiliteteve për studentët.</i> <i>Evidenca 2.14 Lista e studentëve që kanë kryer mobilitete.</i> <i>Evidenca 4.6 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022).</i>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	GVJ, bazuar në dokumentacion por edhe nga takimi që pati me stafin akademik të programit të studimit, evidentoi se fakti që në thuajse të gjitha lëndët që zhvillojnë, studentët përgatisin detyra kursi individuale apo edhe në grup, I ndihmon ata për të menduar në mënyrë analitike. Gjithashtu në një pjesë të mirë të lëndëve, ata duhet të bëjnë kërkim shkencor të mirëfilltë në lidhje me tematikat e përcaktuara nga pedagogët përkatës të lëndëve, duke u ardhur këshyru në ndihmë të gjitha njohuritë teorike dhe praktike të përvetësuar gjatë lëndës Metodave të kërkimit. Punimi I diplomës, që ata duhet të realizojnë në përfundim të studimeve, është një kërkim I thelluar në tematika dhe problematika të përcaktuara së bashku me pedagogun udhëheqës. Gjithashtu, studentë që kanë përfunduar këtë program studimi, pranë Fakultetit të Ekonomisë, janë personel akademik me kohë të plotë dhe janë të rregjistruar tashmë për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve. <i>Evidenca 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset).</i> <i>Evidenca 5.1 Rregullore e diplomimit të studentëve.</i> <i>Evidenca 2.9 Evidence Microsoft Teams kontaktet pedagog student per udheheqjen e mikrotezes.</i> <i>Evidenca 2.8.1 Formati i diplomës MSHMR</i> <i>Evidenca 2.21 Studente te programit te studimit MSHMR te perzgjedhur per ciklin e III-te te studimeve</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Nga takimet që GVJ pati me stafin akademik, sikurse edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ evidentoi se Institucioni i kushtonte rëndësi, pjesmarrjes së stafit akademik në mobilitete të ndryshme në IAL jashtë vendit, sikurse edhe në një sërë projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 4.6 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022)</i> <i>Evidenca 2.20 Projektet FEUT Përfshirja e stafit të Dep. Marketing Turizem në nivel ndërkombëtar e kombëtar.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit, sikurse edhe projekteve ndërkombëtare në të cilat është pjesë, siguron ndër të tjera edhe një politikë integruese edhe për kërkues shkencor të huaj apo staf akademik nga IAL jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 2.16 Mobilitete të personelit akademik të huaj pedagogu pritës.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi institucione jashtë vendit, në kuadër të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik. Studentët përfitojnë nga mobiliteti në Universitete jashtë vendit duke ndjekur module dhe lëndë në këto Universitete dhe më pas nëpërmjet një rregulloreje dhe procedure të përcaktuar nga Universiteti I Tiranës, bëhet njohja apo njëvlerësimi I këtyre lëndëve nga një komision I vecantë.</p> <p><i>Evidenca 2.14 Lista e studentëve që kanë kryer mobilitete.</i> <i>Evidenca 2.14.1 Proçedura për mobilitetet Erasmus për studentet.</i> <i>Evidenca 2.15.1 Njohja e lëndëve nga programet e mobilitetit Studente A. Kristo.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë si edhe Drejtuesin e Departamentit, u evidentua se qëllimi është rritja e profilit ndërkombëtar ndër të tjera edhe të këtij program studimi, duke krijuar për çdo vit akademik edhe një grup me student të cilët e zhvillojnë mësimin në gjuhë të huaj, në anglisht. Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus, mundësojnë mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik në dhe nga IAL jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 2.14.1 Proçedura për mobilitetet Erasmus për studentet.</i> <i>Evidenca 2.16 Mobilitete të personelit akademik të huaj pedagogu pritës</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi V.8


Institucioni i arsimit të lartë ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. N Zyra e Karrierës dhe Alumnit në Fakultetin e Ekonomisë kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve.</p> <p><i>Evidenca 5.9 Rregullore e Zyrës së Karrierës.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse ((<i>Evidenca 1.1- Statuti i UT, neni 129.</i>)), këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, studentët kanë mundësi që të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Të drejtat e studentëve në këtë drejtim përcaktohen edhe në Rregulloren e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit në Fakultetin e Ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca 5.9 Rregullore e Zyrës së Karrierës.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Referuar dokumentacionit, (<i>Evidenca 5.9 Rregullore e Zyrës së Karrierës, neni 6</i>) janë të përcaktuara qëllimi dhe aspektet e komunikimit në Fakultetin e Ekonomisë për ti shërbeyer nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, që nga organizimi i përvitshëm i prezantimit të programeve të studimeve në ambjentet e Fakulteteve, informimin e studentëve, lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, dhe mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe gjatë vizitës që GVJ pati në Institucion, u evidentua se një nga detyrat që ka Zyra e Karrierës dhe Alumnit është edhe përpilimi, plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të punësimit për studentët e diplomuar. Nga vizita në institucion, GVJ-së iu konfirmua se kjo zyrë publikon herë pas here njoftime për mundësi punësimi, duke ia dërguar edhe grupeve të studentëve të diplomuar sipas profileve të tyre të studimit.</p> <p><i>Evidenca 5.9 Rregullore e Zyrës së Karrierës</i> <i>Evidenca 2.28 Formulari për përditësimin e të dhënave ALUMNI dhe Alumni Marketing Turizem.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura te tilla si NJSBC Qendrore dhe NJSBC pranë cdo Fakulteti të cilat kanë hartuar procedura për të siguruar cilësinë e programeve. NJSBC pranë Fakultetit të Ekonomisë është një strukturë e re e krijuar në Tetor 2021. Gjatë vizitave në institucion GVJ-së iu referua që kjo njesi ka 8 anëtarë në përbërjen e saj, 6 (gjashtë) anëtarë prej së cilës janë staf akademik i brendshëm pranë – 1(një) për secilin Departament, 1 (një) antëtar i NJSBC dhe 1 (një) student.</p> <p><i>Evidenca 6.3 Vendimi SA nr.43, datë 07.12.2020 Përzgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme Institucionale dhe të Këshillit të Etikës në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2 Vendim i SA, nr.51, datë 23.12.2020 Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin.</i></p> <p><i>Evidenca 6.1 Plani iVeprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2021-2024.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët. Sistemi operativ i sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse (<i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i>). Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet. Në këtë Njësi përfshihen personel akademik i brendshëm i Universitetit si edhe ekspertë të jashtëm dhe 1 student.</p> <p><i>Evidenca 6.7 FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 6.8 Miratimi i planit NJSBC 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 6.10 Vendimi-nr 30 Miratimi i Manualit te performances</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka marrë certifikatën e akreditimit si Institucion. (<i>Evidenca 1.14 Certifikate akreditimi UT</i>). Universiteti i Tiranës bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të NJSBC-së, siç u përmend edhe më lart. NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të të cilësisë, por <i>GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk eidentoi përdorimin e këtyre instrumentave gjatë vitit korent akademik, si psh raporti i vlerësimit për programin e studimit, rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e stafit akademik në nivel departamenti, konkluzionet e nxjerra dhe plan aksioni per t'i vendosur në funksion. Në dokumentacion (Evidenca 6.2.4), eidentohet se ka një raport mbi</i></p>



<p>tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p><i>realizimin dhe përpunimin e pytësorëve të studentëve, por në fakt ky raport është thjesht një informacion përshkrues më tepër se një raport. Gjithashtu shkallet e vlerësimit duhet të jenë më të mirë organizuar.</i></p> <p>Kështu, GVJ sygjeron përdorimin e ketyre instrumentave dhe nxjerjen e rezultateve konkrete si edhe masat në varësi të rezultateve.</p> <p><i>Evidenca 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2 Vendim i SA, nr.51, datë 23.12.2020 Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin.</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik të UT.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.4 Anketimi NJSBC - Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pytësorëve të studentëve.</i></p>
---	--

<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka hartuar plane dhe procedura ndër të tjera edhe për rishikimin e syllabuseve apo rishikimin e planeve të programeve (Evidenca 6.1 Plani I Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2021-2024). Kjo është bërë edhe në kuadër të përmushjes së detyrimit ligjor për përshtatjen me ligjin e ri të arsimit, por edhe si pasojë e politikës institucionale. Përveç përdorimit të mekanizmave të mësipërme, sigurimi i cilësisë shtrihet edhe në rekrutimin e stafit (Evidenca 6.2.6 Vlerësim i PAK për perseritje kontrate), organizimin e programit mësimor, zhvillimin e programit (Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT) dhe kërkimin. NJSBC synon të sigurojë cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ, në përmbajtje të të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk gjeti ndonjë praktikë konkrete të realizuar nga NJSBC. Kështu, GVJ, duke qenë se NJSBC në Fakultetin e Ekonomisë, është një strukturë e re, sygjeron të qenit më prezent të saj, me plan veprimi konkret dhe të aktualizuar në sigurimin e cilësisë në të gjithë komponentët e sipërpërmendur.</i></p>
--	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Njësia bazë për menaxhimin e programit të studimit është Departamenti. Grupet e Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel Departamenti së bashku me NJSBC e ngritur në nivel Institucional kryen mbikëqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve. Sic përmendet edhe tek Raporti vjetor NJSBC, kjo Njësi ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të saj.</p>

	<p><i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i> <i>Evidenca 6.7 FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë.</i> <i>Evidenca 6.8 Miratimi i planit NJSBC 2021-2022</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamentet në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë hartojnë planin për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p> <p><i>Evidenca 6.8 Miratimi i planit NJSBC 2021-2022</i> <i>Evidenca 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë.</i> <i>Evidenca 6.2 Vendim i SA, nr.51, datë 23.12.2020 Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të të cilësisë (<i>Evidenca 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i>).</p> <p>Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve, institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimi i studentëve me anë të një pyetësoari (<i>Evidenca 6.2.4 Anketimi NJSBC - Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve të studentëve.</i>) 2. Niveli i kënaqësisë për personelin akademik (<i>Evidenca 6.2.5 Formular i vlerësimit nga personeli akademik.</i>) 3. Anketim për stafin akademik PAE (<i>Evidenca 3.8 Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik të UT</i>) dhe PAK (<i>Evidenca 6.2.6 Vlerësim i PAK per perseritje kontrate</i>), 4. Vlerësimi I performancës për stafin ndihmës akademik (<i>Evidenca 6.10.1 Performanca e stafit ndihmes akademik VENDIMI NR.3 DT.24.01.2022</i>) 5. Mësimdhënia, kërkimi shkencor, bashkëpunimet dhe projektet në mbështetje të programeve të studimit <i>Evidenca 6.11 Raporti FEUT 2020-2021; Evidenca 6.5 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i>) 			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, dokumentohen duke ju vënë në dispozicion drejtuesve të njësisë bazë (<i>Evidenca 6.5 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i>), njësisë kryesore (<i>Evidenca 6.11 Raporti FEUT 2020-2021</i>) dhe Institucionit (<i>Evidenca 6.6 Raporti vjetori UT-së 2019-2020</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Në raportet vjetore të Departamentit, njësisë kryesore dhe Institucionit dhe në raportin e NJSBC përfshijnë vetëm rezultatet e vlerësimit por GVJ sygjeron se në to duhet të përfshihet një analizë e detajuar e matësve sasior dhe të adresohen masat e marra për mangesitë e ndryshme të evidentuara.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3


Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Departamenti i Marketing Turizmit i cili është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, bën vlerësime periodike të brendshme për programin e studimit dhe i pasqyron në raportin vjetor të anaizës mësimore në nivel departamenti.</p> <p>Gjithashtu, departamenti realizon në mënyrë periodike analizë të punës mësimore, ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës në departament, por edhe në nivele të tjera më të larta në qoftë se është e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Marketing Turizmit (<i>Evidenca 2.5 Plani strategjik i Departamentit Marketing Turizem (DMT)</i>), Fakulteti i Ekonomisë sikurse edhe Universiteti i Tiranës (<i>Evidenca 1.4 Strategjia per mesimdhenie ne UT; Evidenca 1.6 Plani kerkimit shkencor UT (2018-2022)</i>), sikurse edhe NJSBC (<i>Evidenca 6.8 Miratimi i planit NJSBC 2021-2022</i>), kanë hartuar strategjinë e tyre të zhvillimit bazuar në komponentët e cilësisë. Raportet e realizuara nga këto njësi bëhen duke përdorur instrumentat dhe metodat e përmendura edhe në kriteret e sipërpërmendura.</p> <p><i>Evidenca 6.5 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca 6.11 Raporti FEUT 2020-2021</i> <i>Evidenca 6.6 Raporti vjetori UT-së 2019-2020</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti Marketing Turizmit, për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; intervista të drejtpërdrejta; testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së</p>	<p>Si pjesë e rëndësishme e filozofisë së Universitetit të Tiranës, studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423




Web site: www.ascal.al



Faqe 77

<p>programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program</p>	<p>përfaqësuesve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - janë të përfshirë në procesin e vlerësimin të programeve të studimeve (pjesë e GVB). (Evidenca 0.3. Dosja e Aplikimit per Akreditimin e Programit te studimit). - këshillohen me stafin akademik dhe shefin e departamentit si edhe përdorin zyrat mbështetëse për këtë qëllim. - kanë formuar Këshillin Studentor (neni 133 i Statutit të UT). - Studentët kishin përfaqësuesin e tyre në zyrën e NJBSC (neni 41 i Statutit të UT), - merrnin pjesë në Senatën Akademik (neni 30 i Statutit të UT), - merrnin pjesë në Këshillin e Etikës (neni 43 i Statutit të UT). <p>Gjatë takimit që pati në institucion, <i>GVJ evidentoi se në nivel institucional por edhe në nivel njësie bazë të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, nuk kryhen vazhdimisht sondazhe për studentët, stafin akademik dhe atë ndihmës.</i></p> <p>GVJ sygjeron kryerjen e sondazheve por edhe aplikimin e planeve të veprimeve në rast të evidentimit të mangësive, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka hartuar standardet për sigurimin e cilësisë të institucionit në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm (Evidenca 6.2.1 Manuali për sigurimin e cilësisë) dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shperndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj.</p> <p><i>Evidenca 6.1 Plani i Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2021-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT.</i></p> <p><i>Evidenca 6.7 FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit</p>	<p>Rregullorja e NJSBC-së përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë UT.</i></p>



të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.									
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	<p>Departamenti i Marketing Turizmit është njësi bazë përgjegjëse për cilësinë e programit. Disa nga anëtarët e departamentit janë pjesë e komisioneve të tilla si Komisionet për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor.</p> <p>Rregullorja e insitucionit, Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë dhe Rregullorja e NJSBC, parashikojnë angazhimin e anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit në mënyrë të barabartë,</p>								
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>GVJ, bazuar në dokumentat e vënë në dispozicion nga Institucioni, konkretisht në Statutin e Institucionit dhe Kodin e Etikës, evidenton theksin që Institucioni vendos në parimin e barazisë kundrejt studentëve, stafit akademik dhe ndihmës akademik, por gjithashtu thekson edhe respektimin e integritetit akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti Ri I UT me shkresë, neni 6, pika dh.</i> <i>Evidenca 1.20 Kodi i Etikës UT, neni 4, pika j.</i></p>								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	<p>Universiteti në nivel fakulteti si edhe Departamenti, ka realizuar takime me biznese dhe ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Leksione të hapura "Open Air University".</i></p>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Në përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Në përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Në përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Insitucioni zhvillon pyetësor me studentët për vlerësimin e moduleve në fund të cdo semestri sikurse edhe të stafit akademik dhe ndihmës akademik. Rezultatet e pyetesorëve, sikurse përmendet edhe në rregulloren e NJSBC, i vihen në dispozicion drejtuesve të insitucionit si edhe vetë anëtarëve të stafit akademik. Ato diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe merren masat e nevojshme në rast problematikash.</p> <p><i>Evidenca 6.2.4 Anketimi NJSBC - Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve të studentëve.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 79

	<i>Evidenca 6.7 FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë.</i>			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC harton një plan vjetor të përvitshëm, ku parashikon të gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Me pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Gjithashtu NJSBC informon në mënyrë periodike rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin akademik rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësite të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. <i>Evidenca 6.8 Miratimi i planit NJSBC 2021-2022</i>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pas rezultateve të vlerësimit, NJSBC-ja harton një raport i cili përcillet tek njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre, duke dhënë sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë. Propozime të NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit për tu reflektuar në vendimmarrje konkrete			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC harton raporte vjetore të vlerësimit të Brendshëm ku pasqyron rezultatet e vazhdueshme të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të institucionit. Gjithashtu rezultatet diskutohen në Rektorat dhe Bordin e Administrimit, u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Universiteti i Tiranës i kushton rëndësi trajnimit të stafit për përmirësimin njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies. Universiteti organizon leksione të hapura sikurse merr mendimin e studentëve nëpërmjet këshillit studentor, mbi çdo program studimor në tërësi, apo për çdo lëndë e pedagog të veçantë. Gjithashtu, Institucioni aplikon trajnimin e pedagogëve të rinj duke i ndihmuar ata në këtë mënyrë jo vetëm me metodat e mësimdhënies por me një tërësi elementësh që kanë të bëjnë edhe me sigurimin e cilësisë. <i>Evidenca 2.10 Leksione te Hapura</i> <i>Evidenca 1.4 Strategjia per mesimdhenie ne UT.</i> <i>Evidenca 1.19 Vendim per Ngritjen e Qendres Virtuale te Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit UT.</i> <i>Evidenca 5.7 Rregullore e Keshillit Studentor.</i> <i>Evidenca 4.5 Trajnimi i pedagogëve të rinj.</i> <i>Evidenca 5.12 Tavolina Diskutimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Marketing” ofruar nga “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit ka një rritje të numrit të pedagogëve në tre vitet e fundit duke krijuar bazat për një cilësi më të lartë akademike si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkimin shkencor.
2. Ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm i programit të studimit, i mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga BE-ja, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca tematike.
3. Reputacioni i mire dhe jetëgjatësia në treg e bëjnë Fakultetin Ekonomik dhe programet e studimit që ai ofron atraktiv për studentet potencialë.
4. Cilësia në rritje e studenteve që zgjedhin programin e studimit Master Shkencor në Marketing.
5. Programi po krijon mekanizma të përshtatshëm dhe fleksibël për monitorimin dhe vlerësimin e aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik.
6. Staf proaktiv dhe i angazhuar për të institucionalizuar proceset që lidhen me cilësinë e programit të studimit.
7. Megjithëse aktualisht vërehet një numër i ulët i pjesëmarrjes së studentëve në punimet shkencore, trupa mësimore po i kushton një rëndësi integritit në rritje të studentëve në projektet shkencore sidomos nëpërmjet aktiviteteve të organizuara në kuadër të projekteve

Pika të dobëta:

1. Mungesa e një metodologjie të mirëfilltë për identifikimin e kompetencave aktuale dhe të ardhshme që lidhen direkt me programin e studimit. **(Standardi 2)**
2. Në nivel institucional por edhe në nivel njësie bazë të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, nuk kryhen vazhdimisht sondazhe për studentët, stafin akademik dhe atë ndihmës akademik. **(Standardi VI.3, kriteri 5)** dhe nuk adresohen masat e marra për mangësitë e ndryshme të evidentuara. **(Standardi VI.2, kriteri 5)**
3. Mbështetja financiare nga ana e Institucionit për publikimet në revistat shkencore të cilat në përgjithësi kanë tarifa publikimi të konsiderueshme është e dobët. **(Standardi V, kriteri 4).**



Rekomandime:

1. GVJ vlerëson që IAL nuk ka evidentuar konkretisht kompetenca dhe aftësi që lidhen direkt me Masterin Shkencor Marketing. Kësisoj nevojitet një përmirësim i tij jo vetëm në drejtim të identifikimit të kompetencave konkrete por edhe në shtrirjen e studimit të tregut në një përfaqësim më të gjerë aktorësh. IAL disponon të gjitha mundësitë si nga këndvështrimi metodologjik por edhe në drejtim të rrjetit të aktorëve që akseson nëpërmjet bordeve të punës. GVJ i rekomandon DMT-së të hartojë një analizë më të plotë të tregut punës për programin e studimit MSc në “Marketing”.
2. GVJ të hartohet një analizë Benchmarking ku të analizohen programe studimi të ngjashme në rajon BE dhe më gjerë të cilat janë përdorur si referencë për ndërtimin e programit të studimit. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit do t'i shërbejë IAL-së për të ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës.
3. Programi është reflektim i prioritetëve të shkruara në statutin e UT-së dhe rregulloren e DMT por GVJ rekomandon që të integrohen në program më shumë koncepte të marketingut digjital dhe të gjithë elementëve që lidhen me digjitalizimin e shërbimeve marketing në turizëm.
4. GVJ vlerëson që lënda Menaxhim i Marrëdhënieve me Klientin mund të zhvendoset në kategorinë B si lëndë karakterizuese dhe lënda Kërkim tregu i Aplikuar të zhvendoset në kategorinë A sepse përgatit studentët nga ana metodologjike.
5. DMT ka vënë ne dispozicion konferencat dhe artikujt e publikuar nga stafi i angazhuar në departament dhe në programin e studimit por nuk detajohet qartë se cili është numri i artikujve i botuar në revista të Clarivate Analytics dhe Scopus si dhe numri i citimeve respektive. Këto të fundit janë tregues reale të cilësisë së publikimeve dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor dhe për rrjedhojë të personelit akademik. GVJ rekomandon që raportimi i treguesve sasiore dhe cilësore të bëhet konform këtyre kritereve.
6. Pavarësisht volumit të madh të punës që sekretaria mësimore mund të ketë, duhet të organizohet më mirë në hedhjen e të dhënave të studentëve në rregjistrin themeltar, me numrin e tyre të matrikullimit dhe të vërë në punë regjistrat e QSHA.
7. NJSBC, duhet të vazhdojë të punojë për të institucionalizuar të gjitha procedurat që lidhen me garantimin e cilësisë në të gjitha komponentët e programit të studimit duke I reflektuar qëllimet dhe objektivat e saj nëpërmjet planit të punës dhe duke reflektuar procesin se si integrohen gjetjet dhe rezultatet (psh pyetësorët e studentëve) në kurrikulat e programit. GVJ sugjeron përdorimin e këtyre instrumentave dhe nxjerrjen e rezultateve konkrete si edhe masat në varësi të rezultateve.
8. Mbështetje financiare më të madhe për stafin akademik me kohë të plotë në konferenca apo aktivitete ndërkombëtare.


Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in "Marketing" of the Institution of Higher "University of Tirana"

Strengths and affirmations:

1. The study program has increased the number of lecturers in the last three years, creating the basis for higher academic quality in teaching and scientific research.
2. The continuous internationalization of the study program enables academic staff and students to benefit from exchange and interaction with scientific researchers from the EU, including participation in training and thematic conferences.
3. The good reputation and longevity in the HEI market make the Faculty of Economics and its study programs attractive to potential students.
4. The growing quality of students who choose the Master of Science in Marketing study program.
5. The program is continuously creating appropriate and flexible mechanisms for monitoring and evaluating the teaching ability of academic staff.
6. Proactive and committed staff to institutionalize processes related to the quality of the study program.
7. Although there is currently a low number of student participation in scientific works, the teaching body is giving importance to the increasing integration of students in scientific projects, especially through the activities organized within the projects


Weaknesses:

1. Lack of a proper methodology for identifying current and future competencies directly related to the study program. **(Standard 2)**
2. At the institutional level but also the level of the basic unit of the department responsible for this study program, surveys are not continuously conducted for students, academic staff and academic assistants **(Standard VI.3, criterion 5)**, and the measures taken for the various identified deficiencies are not addressed. **(Standard VI.2, criterion 5)**
3. The institution's financial support for publications in scientific journals, which generally have significant publication fees, is weak. **(Standard V, Criterion 4)**



Recommendations:

1. The External Evaluation Group (EEG) assesses that the HEI has not explicitly identified competencies and skills directly related to the Marketing Scientific Master. Thus, its improvement is needed in identifying concrete competencies and extending the market study to a broader representation of actors.
2. EEG recommends a Benchmarking analysis of similar study programs in the EU region and beyond, which can be used as a reference for building a sustainable study program. The constant consultation of similar programs inside and outside the country will serve the HEI to build a competitive study program that impacts the labour market.
3. The program reflects the priorities written in the UT statute and the DMT regulation, but EEG recommends that more digital marketing concepts and all elements related to digitalising marketing services in tourism can be integrated into the program.
4. EEG suggests that the module Customer Relationship Management can be moved to category B as a characterising subject and the subject Applied Market Research be moved to category A because it prepares students methodologically.
5. The department of Marketing and Tourism has made available the conferences and articles published by the staff engaged in the study program; however, according to EEG, the department should detail the quality of the research in terms of the number of articles published in Clarivate Analytics and Scopus journals, citations, internationalisation etc.
6. Despite the large volume of work that the teaching secretariat may have, it should be better organised in placing student data in the primary register, with their matriculation number.
7. The unit for quality assurance and curricula NJSBC should continue to work to institutionalise all procedures related to quality assurance in all components of the study program by reflecting its goals and objectives through the work plan and by reflecting the process of how the findings are integrated and results (e.g. student questionnaires) in program curricula. EEG suggests the use of these instruments and the extraction of concrete results as well as measures depending on the results.
8. EEG suggests more significant financial support for full-time academic staff at international conferences or activities.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

